# GAZETA SHQIPTARE








Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com








Viti XXVI - Nr. 7841 E enjte 4 Prill 2019 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)


Opinioni i Ditës

Nga ARSIM SINANI

## Shqiptarët në Maqedoni të Veriut mes doktrinës maqedone e shqiptare



S'do mend se zgjedhjet presidenciale në Maqedoninë e Veriut do të jenë interesant edhe për faktin se është një matje e lehtë, e votuesit, se çfarë disponimi ka në raport me ...

Vijon në faqen 20

Opinioni i Ditës

Nga FATOS ÇOÇOLI

## "Miku" i kryeministrit dhe djalit të tij



Historia e mashtruesit të arrestuar dje, që hiqej herë si sipërmarrës, herë si prokuror e herë si jurist, duke arritur t'u zhvaste afro gjysmë milioni euro tre ...

Vijon në faqen 21



"Shqipëria është në një udhëkryq të madh"

## "Shpërthen" Ditmir Bushati: Pse nuk po e gjejmë gjuhën si fqinjët tanë?!

Ish-ministri kritika për sjelljen e PS dhe kërkoi që të mos jetë arrogante me opozitën

Nga foltorja e Kuvendit, ish-ministri i Jashtëm, Dimtir Bushati në një fjalim të ndryshëm nga shumë kolegë të tij socialistë, u shpreh kritik në lidhje me situatën në të cilën ndodhet Shqipëria, ndërsa shprehu nevojën që mes mazhorancës dhe opozitës të gjendet mirëkuptimi. Ndërsa nga një anë ai kritikoi vendimin e opozitës për djegien e ...

Në faqen 2

PRONARET DUHET TE TERHEQIN DOKUMENTIN NE ZYRAT E REGJISTRIMIT TE PASURIVE

# HIPOTEKA: 1100 FAMILJET QE MARRIN TAPITE E SHTEPIVE

Sipërfaqja e parcelës për të cilën miratohet kalimi i së drejtës së pronësisë nuk mund të jetë më e madhe se trefishi i sipërfaqes së bazës së ndërtimit



*(Në foto)* Ndërtime informale

Në faqet 9-11

KREU I OPOZITES

## "Ky vend ka zot", Basha: Shqiptarët janë ngritur kundër "Maduros"

Në faqen 4

PROTESTA

## Opozita "rrethon" parlamentin, rrihen "të infiltruarit" në protestën e PD

Në faqen 5

SHKODER

## "Fajdexhinjtë" e Shkodrës, Apeli liron 6 prej të arrestuarve, 6 të tjerë mbeten në burg

Në faqen 7

FLET FATOS MALAJ



## Nënshtetësia greke, cilat janë ndryshimet që do të prekin emigrantët shqiptarë

Në faqen 11

Rama: Xhaketa e kreut të Universitetit, e paprekur nga protesta e studentëve

## Rama akuzon rektorin Koni: Fajtor për problemet në UT

*"Autonomia universitare, më e madhe se ç'duhet"*

NGA VOLTIZA DURO

Problemet që mbart Universiteti i Tiranës lidhen me keqmenaxhimin e rektorit të këtij institucioni, Mynyr Koni. Akuza është bërë ditën e djeshme nga kryeministri Edi Rama gjatë një takimi me studentë e





pedagogë të UT-së mbi ecurinë e Paktit për Universitetin. Studentët e pranishëm ngritën shqetësimet e tyre mbi mosrikonstruktimin e godinës dhe mosfunksionimin e bibliotekës dixhitale, e pas kësaj kreu i ekzekutivit theksoi se autonomia ...

Në faqen 10

RAPORTI

## FMN, kundër lehtësive fiskale, krijojnë mundësi për shmangie taksash

Në faqen 8

# KRIZA POLITIKE
## KUVENDI

### Blerina Gjylameti zëvendësohet me Damian Gjiknurin

# PS shtyn reformën zgjedhore me 1 muaj, i jep PD të drejtën e vetos

Partia Socialiste i jep sërish Partisë Demokratike të drejtën e vetos në Komisionin e Reformës Zgjedhore. Pavarësisht se PD nuk është më pjesë e Kuvendit të Shqipërisë, socialistët kanë miratuar dje me shumicë votash ndryshimet në vendimin e mëparshëm të këtij institucioni dhe që ka të bëj me ngritjen dhe mënyrën e funksionimit të Komisionit të Reformës Zgjedhore, ku i japin kësaj force të drejtën për të patur një përfaqësues në cilësinë e vëzhguesit, por me të drejtën e vetos në vendimmarrje. Më konkretisht Kuvendi votoi dje ndryshimin që përcakton se "pranë Komisionit caktohet, në cilësinë e vëzhguesit, përfaqësuesi i partisë më të madhe të opozitës(PD), sipas



rezultatit të zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë të vitit 2017, i cili gëzon të drejtat e plota të përcaktuara në pikën VIII si dhe ato të pikës IX të këtij vendimi që i përkasin bashkëkryetarëve të Komisionit". Por, në fakt, çfarë parashikojnë këto dy pika dhe cilat janë të drejtat që i japin socialistët Partisë Demokratike? Pika VIII që i referohet ndryshimit të miratuar gjatë seancës së djeshme përcakton se "Çdo parti që përfaqësohet në komision, ka të drejtë të propozojë amendamente për diskutim dhe miratim. Shumica parlamentare mirëpret propozimet e pakicës parlamentare dhe palët duhet të angazhohen të gjejnë konsensusin në lidhje me to". Pra, nëpërmjet kësaj pike PD rimerr sërish të drejtën, pavarësisht se do përfaqësohet me vëzhgues, për të bërë propozime në komision, si gjithë anëtarët e tjerë. Ndërkohë që pika IX përcakton se "Mbledhjet e Komisionit janë të vlefshme kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve të Komisionit. Vendimmarrja e Komisionit do të synojë konsensusin e gjerë për të gjitha propozimet. Vendimet e Komisionit quhen të miratuara me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve, por vetëm kur kanë marrë njëkohësisht konsensusin e të dy bashkëkryetarëve". Pra, nëpërmjet dhënies së të drejtave që burojnë nga pika 9 e këtij vendimi, socialistët i kanë ofruar PD-së të drejtën për të vënë veton për çdo vendim që do miratohet në këtë komision.



Seanca e djeshme parlamentare

### Ish-ministri kritika për sjelljen e PS dhe kërkoi që të mos jetë arrogante me opozitën

# Bushati: Ruçi, Majko, pse nuk gjejmë gjuhën si fqinjët tanë?

## *"Çfarë do t'i themi sot ne një 30-vjeçari?"*

Nga foltorja e Kuvendit, ish-ministri i Jashtëm, Dimtir Bushati në një fjalim të ndryshëm nga shumë kolegë të tij socialistë, u shpreh kritik në lidhje me situatën në të cilën ndodhet Shqipëria, ndërsa shprehu nevojën që mes mazhorancës dhe opozitës të gjendet mirëkuptimi. Ndërsa nga një anë ai kritikoi vendimin e opozitës për djegien e mandateve, nga ana tjetër i kërkoi edhe të tijve që të mos tregohen arrogantë ndaj saj. "Nuk ka një mendje racionale, qoftë kjo shqiptare apo ndërkombëtare për të legjitimuar djegien e mandatave si instrument politik për të arritur një objektiv të caktuar. Megjithatë nuk mund ta mohojmë faktin se boja, vezët, vaji, mielli në parlament kanë dalë sot në rrugë. Sot në rrugë janë zëvendësuar me kapsollën, nga përplasja gabimisht e muskujve me policinë dhe tek baltosja e institucioneve të shtetit shqiptar. Duke dalë nga parlamenti, unë jam i bindur që opozita ka dëshmuar një lloj frike dhe një lloj kapitullimi. Kjo nuk mund të na bëjë ne të jemi arrogantë", - tha Bushati. Ndaj ai nuk i kurseu kritikat edhe ndaj kryeministrit, duke theksuar se mazhoranca nuk mund të merret gjithë ditën me protestën e opozitës. "Nuk mund të na bëjë ne të harxhojmë orë të tëra duke u marrë me protestat e opozitës. Ne nuk mund të biem në kurthin e profecisë vetëpërmbushëse. Ne jemi PSSH, ne jemi socialistë, demokratë, progresist. Ne duam që të ndërtojmë një shoqëri të drejtë, një shoqëri më të mirë, për fëmijët tanë, por edhe për fëmijët e opozitës që mungon këtu në sallë", - deklaroi Bushati. Në këtë aspekt ai u shpreh kundër edhe zëvendësimit të opozitës politike me atë parlamentare, duke theksuar se demokracia është edhe procedurë ligjore, por edhe frymë. "Demokracia procedurë është zëvendësimi formal i listës së partisë demokratike dhe lëvizjes socialiste për integrim. Por demokracia është edhe thelb dhe fakti që ne krijojmë mundësinë për një marrëveshje të ardhshme për kodin zgjedhor për rregullat e lojës, qoftë me opozitën parlamentare por mbi të gjitha për opozitën politike, besoj se është shprehja më e lartë e ndërgjegjësimit që ka PS, socialistët progresistë shqiptarë për fatet e demokracisë dhe për fatet e Shqipërisë", - theksoi Bushati. Më tej ish - ministri u shpreh se Shqipëria është në një udhëkryq të madh dhe se tashmë ishte momenti që edhe ajo ashtu si vendet fqinje duhet të tregonte pjekuri dhe e gjithë klasa politike të merrej vesh për të ardhmen e vendit. "Lexova 'Financial Times', një prej gazetave më prestigjioze në vend. E dini me çfarë hapej në faqen e parë? Me foton selfi të kryeministrit të Maqedonisë së Veriut dhe kryeministrit grek për arritjen e madhe historike pas 3 dekadash. Unë sot pyes. Si ka mundësi z.Ruçi që pas tri dekadash si politikan me eksperiencë, si ka mundësi z.Ulqini, si ka mundësi z.Majko, e deri te kolegia që foli për herë të parë në këtë parlament? Pse kur grekët e maqedonasit e gjejnë gjuhën për të parë përpara, ne nuk paskemi mundësi me e gjet gjuhën me njëri-tjetrin? A jemi të gjithë shqiptarë, a jemi pjesë e një kombi? Pse e kemi kaq të vështirë dhe turpërojmë veten tonë lart e poshtë? Pse nuk e gjejmë dot ne gjuhën për të parë përpara?", - tha Bushati. Në fund ai vazhdoi duke u shpreh se politika shqiptare nuk mund të justifikohet më për prapambetjen, sidomos te brezat e rinj që kërkojnë një të ardhme më të mirë. "Çfarë do t'i themi sot ne një 30-vjecari? 30-vjeçarët që kanë lindur në 89-90 që nuk e dinë çfarë ishte komunizmi, si do ta shpjegojmë këtë prapambetje në raport me fqinjët, jo me Europën e vlerave demokratike. Do vazhdojmë të themi që ishte faji i komunizmit, ishte faji i Enverit? Prandaj, është momenti i fundit që ne të shohim për nga e ardhmja dhe mos bëhemi nostalgjik të së shkuarës", - deklaroi ai.



Ish-ministri, Dimtir Bushati

**THIRRJA**

"Si ka mundësi z.Ruçi, që pas tri dekadash si politikan me eksperiencë, si ka mundësi z.Ulqini, si ka mundësi z.Majko, e deri te kolegia që foli për herë të parë në këtë parlament? Pse kur grekët e maqedonasit e gjejnë gjuhën për të parë përpara, ne nuk paskemi mundësi me e gjet gjuhën me njëri-tjetrin".

### Sandër Lleshaj: Jo më qendra votimi në ambiente private

Ministri i Brendshëm, Sandër Lleshaj tha dje se ngritja e qendrave të votimi nëpër ambiente private, duhet të marrë fund. Sipas tij, kjo metodë intimidon votuesit dhe i duhet dhënë një zgjidhje, duke ngritur qendra mobile, të lëvizshme. Fillimisht do të aplikohet në Tiranë dhe më pas do të shtrihet edhe në zona të tjera të Shqipërisë. "Një pjesë e madhe e qendrave të votimit në Shqipëri janë mjedise private, nganjëherë janë edhe restorante, pijetore, mejhane ku dita e zgjedhjeve shndërrohet në një lloj rituali të pakëndshëm për shumë qytetarë, të cilët tek dera e lokalit ku shkojnë për të votuar, ndeshen dhe me gjysmën e fisit të pronarit. Shpeshherë intimidohen, shpeshherë vihen në kushte të vështira, por jo rrallëherë edhe heqin dorë nga votimi. Kështu që, ne i kemi propozuar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) që të aplikohet një standard tjetër, që të hiqet dorë nga qendrat e votimit pranë mjediseve private dhe të aplikohen qendrat mobile ose të lëvizshme të votimit. Është gati Bashkia e Tiranës për ta aplikuar, por mendojmë që në të gjithë vendin mund të aplikohet një standard tjetër, i cili aplikohet në vendet e Bashkimit Europian, ku qendrat e votimit afrohen pikërisht në vende publike, në vendet më të arritshme nga qytetarët dhe eliminohet rituali i vizitës së tyre në restorante dhe në pijetore për të votuar", - tha Lleshaj.

REDAKSIA: **Redaktor i Suplementeve dhe Sociales:** Rezarta Delisula, **Redaktor i Rretheve:** Trëndafile VISHA, **Redaktor i Kulturës:** Fatmira Nikolli, ***Art Designer:*** Nevila SAMARXHI.
ADMINISTRATA**: Përgjegjëse e Financës:** Alma Smokthina 0682074397, **Shpërndarja:** Elvis Llaka Cel 0682074416**, *Marketingu*:** Cel:**0688087823-*email:marketing@gazetashqiptare.com***, **ADRESA**: Ish-Drejtoria e Uzinës së Autotraktorëve, Tiranë - Tel:(04) 2359-104 Tel&Fax:(04) 2359-116 ***Marketingu*:** Tel:(04) 2359-104/359-123. Tiranë, **Internet**: www.balkanweb.com, **Email**: gazetashqiptare@hotmail.com; redaksia@gazetashqiptare.com, **SHTYPUR në "Klasik"Shpk**



Kreu i qeverisë hodhi poshtë mundësinë e ardhjes së negociatorëve të huaj për krizën

# Rama thirrje opozitës së re: Krijoni alternativë, PD-LSI për skrap

## "Nuk kemi për t'i hapur rrugë kurrë kësaj zgjidhjeje"

Kryeministri Edi Rama është shprehur edhe një herë i sigurtë dje se Partia Demokratike dhe Lëvizja Socialiste për Integrim me sjelljen e tyre politike po shkojnë drejt asgjësimit. Nga foltorja e Kuvendit, ai hodhi poshtë çdo mundësi që të ketë negociata dhe dialog me opozitën për të ndërprerë mandatin e qeverisë, ndërsa theksoi se opozita nuk do mund të kthehet më në parlament përveçse me votë. "Nuk kemi për t'i hapur rrugë kurrë kësaj zgjidhjeje. Ata që ikën dhe që braktisën detyrën dhe shkelën me këmbë të drejtën e atyre që i votuan për t'i përfaqësuar, nuk kanë për t'u kthyer këtu përmes një rruge ekstraligjore dhe përmes asnjë lloj dialogu që të çon në një pazar të kësaj natyre. Kjo nuk ka për të ndodhur", - tha kryeministri. Ndaj ai shtoi se kërkesa e opozitës për zgjedhje të parakohshme nuk do të plotësohet vetëm se kështu do ajo. "Zgjedhje të parakohshme, se tani na ka mbetur fallxhorja pa rrogë, nuk ka. Të vazhdojë të hedhë fall dhe në atë zonë atje ku ka nevojë dhe për shumë shpresë, falli paguhet dhe të shkojnë të paguajnë filxhan për filxhan dhe të mbajnë në këmbë frymën e revolucionit të filxhanit, por këtu jo", - shtoi Rama. Më tej ai theksoi se mazhorancës nuk mund t'i imponohet askush, duke theksuar se ai nuk do të pranojë kurrsesi që të vijnë negociator për të rikthyer opozitën në parlament. "Ata mund të kenë akoma shpresë që këtu do vijnë nga qielli negociatorë dhe do na ulin në tavolinë e do na thonë, "hë, tani djema, si do ta normalizoni këtë punë?". Ka vetëm një normalizim të mundshëm, të nevojshëm, të domosdoshëm, mbyllja e kapitullit, 30 vjet, "unë po iki, po s'më thirre"; "unë s'rri, po s'më dhe atë dua"; "unë po bëj këtë, po s'më bëre atë". Ky kapitull do mbyllet tani!", - tha kryeministri. sipas tij çdo parti politike kur vjen në Kuvend duhet të respektojë vullnetin dhe verdiktin e popullit edhe kur ai ka vendosur që të jetë në opozitë. "Nuk ka xinxri-finxri, jo jam në opozitë, po e dua pushtetin të nesërmen e betimit, se dua zgjedhje të parakohshme. Ato mund të bëhen për propagandë, por nuk mund të bëhen me metoda kërcënimi, me metoda shantazhimi, me metoda bllokimi. Një gjë duhet ta kenë shumë të qartë, Partia Socialiste e Shqipërisë e ka mision historik sot, të mbyllë këtë kapitull të gjatë zvarritjesh në histori; "jo, po ulemi", "jo, po negociojmë", "të vijë mediatori", "të thërrasim këtë, apo të marrim dy ambasadorë". Nuk ka më të tilla. Ka Kushtetutë. Ka ligj. Ka mandat", - u shpreh Rama. Gjithsesi ai për herë të parë nuk i ka përjashtuar zgjedhjet e parakohshme si mundësi, por ai theksoi se në rast se ato do të ndodhin, kjo do të vijë thjesht dhe vetëm si rrjedhojë e vullnetit të PS-së dhe jo imponimit të opozitës. "Ne nuk e kemi marrë mandatin për ta negociuar përpara sesa të vijnë zgjedhjet e vitit 2021. Ka, s'ka zgjedhje të parakohshme, këtë gjë kurrë nuk mund ta përcaktojë shantazhi, kërcënimi dhe asnjë lloj negocimi, zero. Kjo është pjesë e mënyrës sesi ndërtohen strategjitë e brendshme, por kjo është thjesht dhe vetëm vullnet i njëanshëm i Partisë Socialiste të Shqipërisë, në rast se do të gjykojmë ne, por jo për shkak të tyre", - u shpreh Rama. Në fund të fjalës së tij ai i bëri thirrje opozitës së re parlamentare që të krijojë një alternativë serioze, pasi sipas tij tashmë PD dhe LSI do të shkrihen. "I kemi mundur, edhe juve bashkë me ata, ju kemi mundur, do t'ju mundim përsëri. Mblidheni mendjen mirë. Do t'ju mundim më thellë. Kështu që bëni mirë të ndaheni një orë e më parë nga ata, jo thjesht kush është brenda, kush është jashtë, por t'i jepni Shqipërisë një mundësi tjetër, që të ketë një zgjedhje tjetër, se ato dy siglat ne do t'i çojmë për skrap",-mbylli fjalën e tij Rama.



Kryeministri Edi Rama

**FILXHANI**

"Zgjedhje të parakohshme, se tani na ka mbetur fallxhorja pa rrogë, nuk ka. Të vazhdojë të hedhë fall dhe në atë zonë atje ku ka nevojë dhe për shumë shpresë, falli paguhet dhe të shkojnë të paguajnë filxhan për filxhan dhe të mbajnë në këmbë frymën e revolucionit të filxhanit, por këtu jo", - shtoi kryeministri Rama.

## Balla: Opozita e re të plotësojë vendet vakante në KQZ

Kryetari i Grupit Parlamentar të PS Taulant Balla në fjalën e tij në parlament tha se Kuvendi i Shqipërisë është legjitim, ndërkohë që theksoi se partitë politike që nuk hyjnë në zgjedhje, nuk janë më parti. "Ky është një parlament legjitim, sigurisht. Kjo sepse ne i jemi përmbajtur totalisht kushteve të KQZ dhe kemi qenë korrekt me të gjithë aktorët e mundshëm në procesin demokratik të zgjedhjeve. Sistemi zgjedhor e ka burimin në Kushtetutë", - tha Balla. Taulant Balla ka shtuar se zgjedhjet vendore të 30 qershorit do të mbahen me këtë Kod, ndërsa u shpreh se PS pret PD për të bërë ndryshimet në Kod për zgjedhjet e tjera. Balla iu ka bërë thirrje opozitarëve që të hyjnë në zgjedhje dhe të mos bojkotojnë. Ai tha se i vjen keq që PD dhe LSI po vetëshkatërrohen dhe nuk hyjnë në zgjedhje. Ai përmendi edhe emigrantët, duke thënë se do përpiqen t'ju japin mundësi atyre të mund të votojnë. Ndërkohë ai i kërkoi opozitës së re që të përmbushë, gjithashtu, detyrimin për të plotësuar vendet vakante në KQZ. "Dua të ritheksoj nevojën që opozita të plotësojë vendet bosh që ka në KQZ. Deputetët e opozitës në përmbushje të detyrimit për formësimin e grupeve parlamentare të marrin përgjegjësitë për plotësimin e këtyre vakancave", - tha Balla.



## Hajdari: Politika ka më shumë se 20 vjet që po rrënon vendin

Deputetja Rudina Hajdari në cilësinë e përfaqësueses së opozitës parlamentare duke komentuar ftesën e kryeministrit Edi Rama për pjesëmarrjen në komisionin e reformës zgjedhore tha se ftesa nuk ishte e sinqertë dhe sa për t'i hedhur hi syve ndërkombëtarëve. "Ftesa e PS për PD për Reformën Zgjedhore është sa për sy e faqe të ndërkombëtarëve. Kërkesa e PS për PD nuk është e sinqertë. Oferta e PS është për ofertë nën tavolinë", - tha Hajdari. Ndërkohë duke replikuar me kreun e grupit parlamentar të PS-së, Taulant Balla, Hajdari tha se ai dhe miqtë e tij kanë më shumë se 20 vjet në politikë dhe kanë prodhuar të njëjtat gjëra, duke lënë pas Shqipërinë. "Keni 20 vjet në politikë. Keni 20 vjet që rrënoni këtë vend. Vetëm e keni shkatërruar këtë vend. I keni bërë reformat sipas interesave tuaja. Nuk mund të flasin të njëjtët persona që kanë kaq vite në politikë për reformë zgjedhore e për ndryshime. Ka kaq kohë që punoni kundër interesave të Shqipërisë", - tha Hajdari. Deputetja demokrate ka hedhur akuza ndaj partive kryesore të cilat sipas saj bëjnë pazare me njëri-tjetrin dhe takohen jashtë vendit. "Ju vini këtu dhe flisni me opozitën jashtë. Unë i kuptoj shumë mirë kodet dhe e di shumë mirë që bëni dhe takime jashtë Shqipërisë dhe diskutoni çfarë do bëni dhe kujt do ia bëni qejfin. Po unë nuk bëhem pjesë e këtij skenari. Le të flasim për një sistem zgjedhor që e meriton Shqipëria", - u shpreh Hajdari.

## Ralf Gjoni: Masakrat në Kodin Zgjedhor i keni bërë në një krevat

Një tjetër deputet i opozitës që foli sot në Kuvend ishte edhe Ralf Gjoni, i cili kritikoi Partinë Socialiste se, së bashku me opozitën që sot gjendet jashtë Kuvendit kanë bërë masakrat zgjedhore në vend. Ai theksoi se nuk mund të ketë zgjedhje, as të parakohshme e as normale, me sistemin aktual proporcional-rajonal me lista të mbyllura. "Demokracia kërkon dialog të hapur, transparencë politike e financiare dhe kompromis. Asnjërën prej këtyre nuk e keni ju. Zoti Kryeministër, ne nuk jemi njëlloj si ata! Njëlloj si ata jeni ju, sepse bashkë në një krevat keni qenë kur keni bërë ato ndryshime dhe masakrën e Kodit Zgjedhor të vitit 2008 dhe ndryshimet famëkeqe kushtetuese, të cilat na kanë sjellë ne sot këtu. Sot na kërkohet të votojmë shtyrjen e afatit të Komisionit për Reformën Zgjedhore në një moment kur i gjithë shteti ka rënë. Shteti është në krizë ekzistenciale. Nuk ka Gjykatë Kushtetuese, nuk ka Gjykatë të Lartë. Presidenti ju konsideron juntë ushtarake, dhe ne këtu na konsideron të paligjshëm. Opozita parlamentare është e paqartë. Dhe ndërkohë, seanca e Kuvendit zhvillohet si njësitë guerrilase, një herë të enjten, një herë të hënën dhe një herë të mërkurën, sikur keni frikë nga gjermanët", - tha Gjoni.

## AKSIONI I OPOZITËS

### PROTESTA

Kryemadhi, ambasadorëve: Ju ikni dhe vini, Shqipëria është shtëpia jonë

# "Ky vend ka zot", Basha: Shqiptarët janë ngritur kundër "Maduros"

## *"Edi Rama është kapur duke vjedhur"*



Protesta e djeshme e opozitës

Valentina Madani

Edhe pse vetë nuk ësh të i pranishëm, lideri i Partisë Demokratike, Lulzim Basha, përcolli dje 'live' në faqen e tij në "Facebook" protestën e opozitës para Kuvendit. Z.Basha shprehet se qytetarët shqiptarë janë ngritur kundër "Maduros së Ballkanit", i cili është kapur duke vjedhur. Basha përshëndeti protestuesit nga Gjermania. Përmes një postimi në rrjetin social, ai inkurajoi aktivistët që të vazhdojë përpara për të rrëzuar kryeministrin Edi Rama. Përmes pamjeve të drejtpërdrejta nga protesta e djeshme, kryedemokrati Basha siguroi se ky vend ka zot. "Qytetarët shqiptarë janë ngritur kundër 'Maduros së Ballkanit', i cili është kapur duke vjedhur. Ky vend ka zot! Sovrani në Republikën e Shqipërisë është populli shqiptar", shkruan Basha. Shefi i opozitës, dje ndodhej për një vizitë në Berlin, ku pati takime me zyrtarë të CDU-së dhe Partive Popullore Evropiane. Në qendër të takimeve ishte situata politike në Shqipëri dhe aksioni i opozitës për largimin e qeverisë "Rama". Vizita e shefit të opozitës në Gjermani vjen pas asaj në Bruksel, ku z.Basha u takua me kryetaren e CDU, Annegret Kramp-Karrenbauer, presidentin e PPE Joseph Daul dhe eurodeputetë. Vizita e kreut të PD në Gjermani është e para që pas djegies së mandateve dhe kërkesave të opozitës për krijimin e një qeverie tranzitore dhe zgjedhje të parakohshme parlamentare.

**KËRKESAT**

Kryetarja e LSI, Monika Kryemadhi, paralajmëroi dje se protestat do të vazhdojnë deri në largimin e Ramës dhe plotësimin e dy kërkesave të opozitës. Duke folur për gazetarët gjatë zhvendosjes së protestës nga parlamenti te Kryeministria, Kryemadhi siguroi se opozita nuk do ndalë protestat derisa të marr fund sistemi i antivlerave që ka ngritur Rama. "Nuk ka parë gjë akoma. Nuk është plotësuar asnjë kërkesë e studentëve dhe i kanë futur në një qerthull, që e shton akoma më shumë mungesën e funksionimit të universitetit. Jemi akoma në periudhën e sensibilizimit, shqiptarët janë sensibilizuar më shumë se kushdo tjetër. Po sensibilizojmë socialistët në parlamentin e Edi Ramës dhe po sensibilizojmë edhe atë pjesë të Rilindjes, e cila e kupton se çdo gjë ka marrë fund, por është vetëm një zvarritje, që shton më shumë dëmin në radhët e PS sesa politikisht ndaj opozitës. Protestat nuk do të ndalojnë derisa në Shqipëri të vendoset një sistem i vlerave dhe jo sistem i antivlerave që ka ngritur Rama. Të vendoset ai sistem, ku çdo njeri që vjen në Shqipëri të mos e mendojë Shqipërinë si parajsën e drogës, seksit dhe parasë por si një vend europian", tha zj.Kryemadhi. Sa u takon ambasadorëve në vend, ajo tha se Shqipëria është shtëpia jonë, ndërsa shtoi se ambasadorët vijnë dhe ikin. "Reforma zgjedhore është një proces, që nëse nuk garantohet shitblerja e votës dhe përdorimit të bandave kriminale, ajo është e kotë. Nëse të gjithë këta ambasadorë që na flasin për demokracinë, do ju japin bukën e fëmijëve të tyre shqiptarëve?!... Ata vijnë dhe ikin. Shqipëria është shtëpia jonë jo e ambasadorëve", deklaroi ajo.


Kryetarja e LSI, Monika Kryemadhi, dje në protest

**PARALAJMËRIMI**

"Protestat nuk do të ndalojnë, 13 prill, 23 prill deri sa në Shqipëri të vendoset njëherë e mirë një sistem i vlerave dhe jo një sistem i antivlerave që ka ngritur Edi Rama. Të vendoset ai sistem, që çdo njeri që vjen në Shqipëri të mos e mendojë si parajsën e drogës dhe të parave të pista, por ta mendojë si një vend europian, i barabartë si në Francë, si në Itali, si në Gjermani", tha zj.Kryemadhi.

**ERVIN SALIANJI**

PD-ja përmes ish-deputetit Ervin Saljanji akuzoi dje se emërimi i Andon Markos në krye të policisë së Fierit është shpërblimi që i bëhet atij dhe për t'i mbyllur gojën, pasi audiopërgjimet tregojnë se ai është i përfshirë dhe është përgjuar me Fredi Alizotin. Saljanji tha se Marko e di sa para ka marrë dëshmitari i sajuar për të dëshmuar kundër opozitës.

## Kriza, zyrtari i DASH më 8 prill në Tiranë, takon krerët e politikës


Zv.ndihmës sekretari amerikan i Shtetit, Matthew Palmer

Në kulmin e krizës poli tike, zv.ndihmës sekretari amerikan i Shtetit, Matthew Palmer, do të vizitojë Tiranën gjatë javës së ardhshme, ndërsa ka parashikuar takime me krerët më të lartë të politikës. Ambasada amerikane në vendin tonë konfirmoi dje vizitën e diplomatit, duke e përshkruar atë si pjesë e një turi ballkanik rutinë. Gjithsesi, ajo që mund të thuhet është se ardhja në Tiranë e Palmer i përngjan deri në detaje asaj të paraardhësit të tij në detyrë, Hoyt Bryan Yee, gjatë krizës politike të vitit 2017. Por, çfarë qëndrimi ka mbajtur Palmer për këtë situatë? Ajo që është publikuar deri më tani lidhet me dy telefonata të veçanta, që diplomati ka zhvilluar me kreun e PD-së Basha dhe kryetaren e LSI-së, Kryemadhi, në vigjilje të protestës së 21 shkurtit, ditën kur opozita dorëzoi mandatet. Një zëdhënës i Departamentit të Shtetit tha se z. Palmer i kishte këshilluar dy kryetarët e partive "kundër dorëheqjeve të koordinuara dhe në masë të deputetëve të opozitës nga parlamenti, pasi kjo do të dëmtonte përpjekjet për reforma dhe do të dëmtonte një institucion të rëndësishëm të demokracisë". Palmer gjithashtu është shprehur se të gjithë qytetarët kanë të drejtë të protestojnë paqësisht, por Basha dhe Kryemadhi sipas tij duhet të dënojnë publikisht dhunën. Nga ana tjetër, liderët opozitarë janë përgjigjur duke thënë se djegia e mandateve ka qenë e vetmja zgjidhje përballë qeverisë, që sipas tyre është e lidhur me bandat kriminale.



## Protesta, Paloka: Të gjithë bashkë, derisa Rama të shporret

Nënkryetari i Partisë Demokratike, Edi Paloka, shpre hu dje bindjen se dita e largimit të Edi Ramës si kryeminister është e afërt. Protesta u mbyll në selinë blu me Himnin Kombëtar. Mungesa e kreut të PD-së, Lulzim Basha, bëri që protesta të mbyllej me një fjalim nga nënkryetari Edi Paloka. "Sot (dje) protestën e drejtuan studentët. Shqipëria që ne duam është e studentëve në radhë të parë. DASH e cilësoi Shqipërinë si qendrën e drogës, pastrimit të parave, qendrën ku krimi i organizuar mblidhet për t'u shpërndarë në Europë dhe deri në SHBA. Është një raport që dikur ia kanë bërë vetëm Noriegës, prandaj jemi në protestë derisa ai të shporret. Të jeni të bindur se dita që ai kryeministër që nuk përfaqëson asnjë nga shqiptarët e ndershëm do të largohet është shumë e afërt. Shumë shpejt do ta shihni si do të marrë vrapin. Del dhe numëron sa ishin sot. Ne do të jemi në shesh dhe ai duhet të kuptojë se urrejtja e grumbulluar në shpirtin e shqiptarëve është gjithmonë aty dhe një ditë do ta mbysë. Kemi dalë për t'i dhënë fund jo vetëm atij parlamenti, por një sistemi të tërë të korruptuar. Të gjitha partitë e opozitës do të jemi bashkë derisa kjo qeveri të shporret", deklaroi z.Paloka.




Qytetarët kërkojnë Berishën: O Sali, o hero gjithë Shqipëria ty të do! Kthehu legjendë!

# Opozita "rrethon" parlamentin, rrihen "të infiltruarit" në protestë

## Protestuesit i vënë flakën "piramidës së krimit"

Valentina Madani

Opozita përmbylli dje pas më shumë se 3 orë e gjysmë para Kuvendit, protestën e 8-të të saj për rrëzimin e kryeministrit Edi Rama. Në mungesë të kryetarit të PD-së, Basha, që ishte për vizitë në Berlin, organizimi i protestës u ishte besuar të rinjve, të cilët shpalosën simbolika të shumta kundër qeverisë, që u finalizua dhe me djegien e "piramidës së krimit", që sipas tyre ka ngritur Rama. Banorët e "Astirit" mbërritën të parët në qendër të kryeqytetit për të protestuar para Kuvendit. Rruga "George W.Bush" u bllokua për automjetet. Gjithashtu, edhe pedonalja "Murat Toptani" u bllokua për qarkullimin e këmbësorëve. Policia bllokoi hyrjen për këmbësorët te pedonalja, duke lejuar vetëm kalimin e automjeteve të deputetëve dhe ministrave që i drejtohen Kuvendit për seancë. Forca të Policisë së Rendit, "Shqiponja" dhe disa efektivë të RENEA-s ishin në gatishmëri dhe nuk lejuan gazetarët t'i afrohen kordonit. Të angazhuar ishin mbi 1000 efektivë policie për protestat dhe janë rrethuar të gjitha godinat qeveritare me rrjeta teli. Banorët e "Astirit" tentuan të largojnë barrierat në hyrje të pedonales, por nuk u lejuan.

**PËRPLASJA**

Gjatë momentit që kryeministri Rama mbante fjalimin e tij në foltoren e Kuvendit, pati përplasje mes protestuesve dhe policisë. E para nisi përpara Ministrisë së Brendshme, ku protestuesit tentuan të hynin brenda rrethimit të pedonales. Ata u përplasën me efektivët e policisë për të kaluar perimetrin e sigurisë. Përpara parlamentit protestuesit hodhën kapsolla e tymuese në drejtim të uniformave blu dhe disa herë tentuan të çanin kordonin e policisë. Policia apeloi protestuesit me maska t'i heqin ose të ikin, sepse nuk lejohet të jenë me maska në tubime. "Të nderuar organizatorë të protestës, merrni masa të menjëhershme që protestuesit që kanë mbuluar fytyrën me shall e maska ose të zbulojnë fytyrën, ose t'i largoni menjëherë nga protesta. Sipas ligjit për tubimet, mbulimi i fytyrës dënohet deri në 6 muaj burg. Ju si organizatorë të tubimit mbani përgjegjësi ligjore për mbarëvajtjen e tubimit. Të nderuar qytetarë, ruani gjakftohtësinë. Ruani qetësinë. Mos hidhni kapsolla në drejtim të punonjësve të policisë. Mos u përplasni me punonjësit e policisë", - dëgjohej thirrja në megafon. Fjalimin e parë në protestën e opozitës e mbajti kreu i Forumit të Partisë Demokratike, Belind Këlliçi. Këlliçi tha se protestat nuk do të ndalen deri sa Rama dhe qeveria e tij të largohen për t'i hapur rrugën demokracisë. Në të njëjtën linjë ishte edhe kryetarja e LRI, Florida Kërpaçi. Të lidhur me pranga në duar, veshur me të zeza me bluza ku shkruhet "Liri, demokraci, shpresë", të rinjtë e Forumit Rinor të Partisë Demokratike përcollën me një mënyrë ndryshe mesazhin e tyre për demokraci. Ndryshe nga protestat e tjera dje mesazhet politike në pankarta u shmangën, duke pasur masivisht një pankartë të njëjtë ku shkruhej vetëm "IK".

**INCIDENTET**

Përplasjet nuk munguan as mes protestuesve dhe të "infiltruarve" në tubim, deri në grushte. Nisi me një protestues me kapuç para Kuvendit, i cili u rrah nga militantët dhe më tej me një burrë tek Piramida, që u godit me shpulla në fytyrë dhe shkulje veshi. Ndërsa e fundit që e pësoi nga "revolta" e protestuesve ishte edhe një zonjë. Një situatë kaotike u krijua brenda protestuesve, të cilët sulmuan me grushte një person duke e akuzuar si të infiltruar nga policia dhe provokator. Dyshimet e protestuesve se mes tyre kishte të infiltruar nga radhët e policisë i kushtuan jo pak një të riu, i cili mësohet se ishte një aktivist demokrat nga Elbasani. Është dashur ndërhyrja e ish-deputetit Luçiano Boçi dhe ish-deputetëve të tjerë për të qetësuar situatën. Protestuesit përzunë një grua që sipas tyre i provokonte dhe kundërshtonte. Mes tyre është përpjekur t'i ndajë, ndërkohë që pranë tyre u afrua edhe ish-deputeti demokrat, Klevis Balliu.

**SIMBOLIKA**

Protesta ishte e dominuar nga simbolikat. Mbështetësit e Partisë Demokratike dhe Lëvizjes Socialiste për Integrim mbanin veshur bluza, ku shkruanin liri demokraci dhe të lidhur me njëri-tjetrin me pranga. Tubuesit kishin gjithashtu në duar letra të bardha, ku shkruhej "Ik" si dhe pankarta ku ishte stampuar figura e kryeministrit Edi Rama. Pas parlamentit protestuesit u shpërngulën në krah të Kryeministrisë, ku krahas thirrjeve për largimin e kreut të qeverisë, dogjën edhe një instalacion piramide, që sipas tyre simbolizonte shtetin e inkriminuar të Edi Ramës. Me piramidën në krahë, protesta u zhvendos përbri Kryeministrisë, atje ku ngjitur me piramidën historike iu vendos flaka "piramidës së krimit". Edhe para Piramidës nuk munguan incidentet mes vetë protestuesve. Të rinjtë e forumeve rinore të PD-LSI i vunë flakën në shenjë simbolike një piramide kartoni për të treguar se sistemi kriminal që ka ndërtuar kryeministri Edi Rama ka rënë. Poshtë Piramidës në shesh ata kishin shkruar "Rama ik" dhe kishin vendosur edhe foton e tij. Të lidhur me pranga në duar, të rinjtë e forumeve rinore të PD-LSI e zhvendosën protestën drejt Piramidës. Të zhvendosur aty përpara, protestuesit e opozitës bashkë me ish-deputetë të dy partive kryesore opozitare i kanë vënë flakën një piramide prej letre, e cila sipas tyre simbolizon sipas tyre korrupsionin në vend.

**RIKTHIMI**

Në rrugët e Tiranës dje u panë të ngjitura në shtylla disa fletushka që kërkojnë rikthimin e Sali Berishës në krye të protestave kundër qeverisë "Rama". "O Sali, o hero, gjithë Shqipëria ty të do! Kthehu legjendë", shkruhet në disa prej tyre. Opozita mbajti dje protestën e tetë kundër qeverisë, para Kuvendit. Por, njësoj siç ndodhi më 21 mars, lideri Lulzim Basha nuk ishte në krye të protestës, pasi ndodhet në Gjermani në takime me përfaqësues të partisë CDU. Në mungesë të Lulzim Bashës, i cili ndodhej në Gjermani për takime me zyrtarë të CDU-së për situatën politike në vend, mesazhin kryeministrit Rama ia dha nga selia blu, nënkryetari i demokratëve, Edi Paloka. Dhe mbyllja e protestës u bë sërish me Himnin Kombëtar.



Protesta e djeshme e opozitës

**MBËSHTETËSIT**

Protesta dje ishte e dominuar nga simbolikat. Mbështetësit e PD-së dhe LSI mbanin veshur bluza ku shkruanin "Liri, demokraci" dhe të lidhur me njëri-tjetrin me pranga. Tubuesit kishin gjithashtu në duar letra të bardha, ku shkruhej "Ik" si dhe pankarta ku ishte stampuar figura e kryeministrit Edi Rama.

## Zgjedhjet, Mustafaj: Rama ka frikë se nuk i fiton

Ish-ministri i Jashtëm, Besnik Mustafaj, deklaroi dje në "News 24" se pavarësisht mënyrës se si shprehet dhe kushteve që i vendos Bashës, kryeministri Edi Rama nuk është aspak i bindur se i fiton zgjedhjet. "Rama nuk është aspak i bindur se i fiton më zgjedhjet, sepse do kishte marrë vendimin që të çonte vendin në zgjedhje. Nëse është pragmatist siç thotë, nuk do kishte aspak frikë nga zgjedhjet e parakohshme", shprehet Mustafaj. Sipas tij, Rama nuk jep mundësi diskutimi as në media, pasi shkon në studio të shajë dhe të komentojë gazetarët, por nuk bën debat dhe diskutim produktiv.



**IZMIRA ULQINAKU**

Mbesa e dëshmorit të 2 prillit, Nazmi Kryeziut, ish-deputetja e PD, Izmira Ulqinaku reagoi dje pas ftesës që Rudina Hajdari i bëri mazhorancës në parlament, për nderuar me një minutë heshtje 4 dëshmorët e demokracisë. Ulqinaku tha se paqen e dëshmorëve të votës së lirë e prish ekzistenca e Gramoz Ruçit.



**NDESHKIMI**



## Berisha: Përgjigjja e duhur për policin e infiltruar

Ish-kryeministri Sali Berisha reagoi dje pas dhunës së ushtruar ndaj një polici të infiltruar gjatë tubimit para Kryeministrisë. Berisha e quajti si provokator, personin që u godit nga protestuesit e opozitës, duke thënë se ai mori përgjigjen e merituar. "Narko-polici i infiltruar provokator merr përgjigjen e merituar!", shkruan Berisha. Gjatë protestës së djeshme u shënuan tri incidente të ngjashme, ku dy burra u qëlluan me grushte dhe shkelma nga protestuesit, ndërsa një grua u shty për disa momente derisa u nxor jashtë turmës. Ish-kryeministri Sali Berisha nuk ishte i pranishëm në protestën e djeshme, ndërkohë që sa herë ai ndodhet mes protestuesve, pritet me entuziazëm të madh në protestë.


Ish-ministri, Saimir Tahiri

## Gjyqi, caktohet trupa gjykuese për ish-ministrin e Brendshëm, Saimir Tahiri

**TIRANË** - Në Gjykatën për Krime të Rënda është përzgjedhur dje treshja gjykuese që do të shqyrtojë dosjen ndaj ish-ministrit të Brendshëm, Saimir Tahiri. Mësohet se gjyqtarët e caktuar për këtë çështje janë Ardit Mustafai, Flora Hajredinaj dhe Irena Gjoka. Një javë më parë, Gjykata e Krimeve të Rënda rrëzoi kërkesën për pushimin e çështjes dhe vendosi të dërgojë për gjykim ish-ministrin për akuzat e ngritura nga prokuroria. Ndërsa, vetë Tahiri u shpreh se procesi ndaj tij është në kufijtë e maskaradës. Gjatë seancës paraprake, ish-ministri kërkoi edhe gjykim të shkurtuar, kërkesë e cila do të shqyrtohet nga kjo treshe gjykuese. Hetimet për Saimir Tahirin nisën në nëntor të 2017-ës, pas publikimit të një pjese të dosjes së Katanias, ku në disa përgjime përmendej emri e ish-ministrit, nga anëtarë të grupit Habilaj, drejtuar nga dy kushërinjtë e tij, Artan dhe Moisi Habilaj. Bashkë me Tahirin, në gjykim kaluam edhe 3 ish-policët Jaeld Çela, Gjergji Kohila dhe Sokol Bode, ndërsa më herët kanë kaluar është 9 pjesëtarë të grupit të Habilajve.

### Vendimi, 4 vjet shërbim prove mjekut të qendrës shëndetësore, Ilir Tanku

# Mbyti gruan 2 vite më parë, Gjykata e Krimeve të Rënda dënon me 35 vite burg 67-vjeçarin

## *Ngjarja në shtator të vitit 2017 në Patos, Namik Velaj tentoi të fshihte krimin*

**TIRANË**

Gjykata për Krimet e Rënda në Tiranë ka dënuar me 35 vite burg Namik Velajn, i cili vrau bashkëshorten dy vite më parë dhe u përpoq të fshehë krimin. Gjatë seancës së djeshme u shpall fajtor edhe mjeku Ilir Tanku, i cili punonte si mjek i qendrës shëndetësore të qytetit të Patosit për akuzën "Shpërdorim detyre". Ky i fundit u dënua me 2 vite burg, mirëpo përfundimisht u la nga gjykata në shërbim prove për 4 vjet. Prokuroria në pretencën e saj bëri me dije se 67-vjeçari Velaj mbyti gruan me litar, duke ia bllokuar rrugët e frymëmarrjes, kurse krimi në familje është zbuluar një vit pas ngjarjes. Nga ana tjetër, Prokuroria për Krime të Rënda ka kërkuar burgim të përjetshëm për Namik Velajn si dhe3 vite burg për mjekun Tanku dhe 2 vjet heqje të së drejtës për të ushtruar profesionin e tij. Vrasja ka ndodhur në janar të 2017-ës, por 67-vjeçari u arrestua në mars të 2018-ës, pasi vdekja e Verke Velaj u raportua si natyrale, version i konfirmuar edhe nga mjeku Ilir Tanki, i cili është marrë i pandehur për shpërdorim detyre. Sipas prokurorisë, kanë qenë familjarët e viktimës që kanë dyshuar për vdekjen e së ndjerës dhe kanë bërë denoncim në polici, pas 1 viti hetime rezultoi se Namik Velaj e kishte mbytur me duar bashkëshorten dhe rreth qafës kishte vendosur një shall për të fshehur shenjat e mbytjes.

**NGJARJA**

Në janar të vitit 2017, Namik Velaj është konfliktuar me bashkëshorten e tij, Vreke Velajn në banesën e tyre në Patos dhe e ka keqtrajtuar atë duke e mbytur dhe thyer krahun. Pas vrasjes, ai menjëherë ka nisur të thurë planin për zhdukjen e provave. Ai ka thirrur mjekun e Qendrës Shëndetësore të Patosit, shtetasin Ilir Tanku. Ky i fundit, në shkelje të ligjit, ka përcaktuar se shkak i vdekjes së të moshuarës ka qenë hipertensioni, duke e trajtuar si vdekje natyrale. Në këto kushte, Namik Velaj ka nisur të zhdukë provat për krimin e kryer duke organizuar vetë ceremoninë mortore. Mësohet se i moshuari i ka vendosur viktimës një shall rreth qafës, në mënyrë që të zhdukte shenjat e dhunës në qafën e saj. Një ditë më pas, gjatë ceremonisë mortore, familjarët e viktimës kanë kërkuar që të lëvizin trupin dhe ta shohin, por Namik Velaj ka kundërshtuar. Ai u ka kërkuar atyre që të mos ia hiqnin shallin trupit të viktimës, pasi e kishte amanet nga vajza, e cila kishte ndërruar jetë një vit para ngjarjes. Përkundër insistimit të Velajt, familjarët e viktimës kanë insistuar dhe kanë mundur që t'ia heqin shallin kufomës, duke konstatuar mavijosje të qafës dhe fryrje në shpatull. Që të mos binin në sy tek autori i krimit, familjarët e viktimës kanë preferuar të heshtin dhe ta ndjekin rastin në rrugë ligjore.


Viktima Verke Velaj


67-vjeçari, Namik Velaj

## Procedohen penalisht 7 persona për zjarrvënieve në pyje dhe ndotje të ajrit



**KORÇË** - Shtatë persona janë proceduar penalisht nga policia në Korçë si autorë të zjarrvënieve në pyje dhe kullota, si dhe të ndotjes së ajrit. Sipas policisë, 3 prej tyre akuzohen për veprën penale "Shkatërrimi i pronës me zjarr" dhe 4 të tjerë për veprën "Ndotja e ajrit". Mësohet se specialistët për hetimin e krimeve në Komisariatet e Policisë Korçë, Pogradec, Maliq, Kolonjë filluan procedimin penal në gjendje të lirë ndaj 7 shtetasve. Shtetasi F.J., banues në fshatin Rëmenj, Pogradec, pasi në këtë fshat ky shtetas duke djegur disa barishte, i ka dalë zjarri nga kontrollit dhe për pasojë janë djegur rreth 3 hektarë kullotë dhe shkurre. Shtetasi me iniciale A.D., banues në fshatin Selenicë, Kolonjë, pasi në vendin e quajtur "Përroi i thellë Llobonicë", afër këtij fshati, ka djegur rreth 5 dynymë pyll. Shtetasi E.K., banues në fshatin Pulahë, Korçë, pasi në vendin e quajtur "Kodra e Floqit" ka ndezur një zjarr dhe për pasojë është djegur një sipërfaqe rreth 4000 $m^2$ me shkurre. Shtetasi O.M., banues në fshatin Klocë, Maliq, pasi në vendin e quajtur "Kamina", ky shtetas ka djegur aksidentalisht me një cigare një sipërfaqe 20 $m^2$ bar, duke ndotur ajrin. Shtetasi M.T., banues në fshatin Drithas, Maliq, pasi ky shtetas ka djegur rreth 2 dynym bar në tokën e tij, me qëllim pastrimin e saj, duke ndotur ajrin. Shtetasi me iniciale S.L., banues në Korçë, pasi ky shtetas në tokën e tij ka djegur disa mbeturina dhe goma duke ndotur ajrin. Shtetasi S.P., banuese në Memlisht, Pogradec, pasi në afërsi të tokës në pronësi të saj ka djegur mbeturina duke ndotur ajrin. Materialet në ngarkim të tyre u kaluan Prokurorive të Rrethit Gjyqësore Korçë dhe Pogradec për veprime të mëtejshme.

### Shkrumbohen dy makina gjatë natës, dyshime për zjarrvënie të qëllimshme

**DURRËS** - Dy makina janë djegur në orët e para të mëngjesit të djeshëm në qytetin e Durrësit. Burime për "GSH" bënë me dije se ngjarja ka ndodhur rreth orës 01:30 pranë zyrave të punësimit në Durrës. Të njëjtat burime pohuan se automjeti i djegur është në pronësi të shtetasit Bedri Dërvishi, 50 vjeç, i cili është në betejë ligjore me IKMT, për prishjen e një kioske te Ura e Dajlanit. Nuk dihen akoma rrethanat dhe shkaqet e ngjarjes, nëse është aksidental apo i qëllimshëm. Policia ka shkuar shpejt në vendin e ngjarjes dhe ka nisur hetimet. "Më datë 03.04.2019, rreth orës 02:50, në lagjen Nr.4, Durrës ka rënë zjarr në automjetin në pronësi të shtetasit B.D., 50 vjeç, banues në Durrës dhe për pasojë është djegur pjesërisht dhe automjeti i shtetasit H.H., 64 vjeç, banues në lagjen Nr.4, i cili ishte i parkuar në afërsi. Grupi hetimor ndodhet në vendngjarje dhe po punon për zbardhjen e plotë të ngjarjes", - thuhet në njoftimin zyrtar të policisë së qytetit bregdetar.

## SHKURT

### Mashtronte duke marrë kapar për apartamente, ndalohet kosovari në Tiranë

**TIRANË** - Finalizohet operacioni policor i koduar "Imobiliare", në sajë të të cilit është ndaluar një shtetas kosovar, i akuzuar për mashtrim dhe fshehje të ardhurash. Policia e Tiranës njofton se operacioni nga Seksioni për Hetimin e Krimit Ekonomik dhe Financiar, në bashkëpunim me Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka ndaluar shtetasin - Sh. M., 40 vjeç, lindur në Kosovë dhe banues në Prishtinë. Ky shtetas nën siglën e një agjencie, nëpërmjet mashtrimit u ka marrë shtetasve të ndryshëm shuma të konsiderue-shme paraprakisht në formën e kaparit për blerje apartamenti. Materialet iu referuan Prokurorisë Tiranë për veprime të mëtejshme.

### Ndaluan grabitësin e kambistit 50-vjeçar, shpërblehen 3 rrugorët

**TIRANË** - Ndonëse jo detyrë e drejtpërdrejt e tyre, ndalimi i grabitësit të pronarit të një 'exchange', ka sjellë edhe shpërblimin për tre efektivët e Policisë Rrugore. Ministri i Brendshëm, Sandër Lleshaj takoi tre punonjësit e Policisë Rrugore, të cilët ndaluan dhe arrestuan në flagrancë grabitësin në Tiranë, në tentativën për t'u larguar. Ministri shprehu vlerësimin maksimal dhe theksoi se ky është modeli i suksesit që duhet nxitur, motivuar dhe përhapur në të gjitha strukturat e Policisë së Shtetit.

Gjykata: "Detyrim paraqitje" për ish-prefektin Radovani, ndalohet të dalë jashtë vendit

# "Fajdexhinjtë" e Shkodrës, Apeli liron 6 prej të arrestuarve, 6 të tjerë mbeten në burg

## *Mes të akuzuarve që mbeten në qeli, ish-kancelari i gjykatës, Dragani dhe ish-kreu i Patentave, Ilir Sokoli*

**SHKODËR**

Njëzet ditë pas operacionit të koduar "Maranaj", Gjykata e Apelit në Shkodër la në "arrest me burg" 6 nga personat e arrestuar, ndërsa liroi 6 të tjerë me masën "detyrim paraqitje". Këta 12 shtetas dyshohen se u kanë dhënë para me fajde ish-prefektit të Shkodrës, Paulin Radovani dhe dy djemve të tij. Sipas Apelit, 6 shtetasit që u lanë në burg ditën e djeshme dyshohet se kanë konsumuar veprën penale "ushtrim pa licencë të veprimtarisë bankare", ndërsa kanë si provë përgjime ambientale dhe vëzhgime të fshehta.

**VENDIMI**

Berhan Alija u la në "arrest me burg", pasi dyshohet se i ka dhënë një borxh prej 74 mijë euro ish-prefektit Paulin Radovani me fajde, ndërsa këtë veprimtari sipas dyshimeve e ushtronte bashkë me djalin e tij, Jonuz Alija dhe shtetasin Endri Mustafa, këta të fundit janë në kërkim policor. Jonuz Alija sipas përgjimeve i ka thënë ish-prefektit "mos harro borxhin e babës".

Edhe Edi Memçaj u la në "arrest me burg" për shkak se dyshohet për ushtrim pa licencë të veprimtarisë bankare. Ky shtetas ka disa kontrata huaje me familjen Radovani. Ish-prefekti ka deklaruar për shtetasin Edi Memçaj se nuk e di shumën e saktë sa i ka borxh, por është shprehur se ato para janë dhënë me fajde. Pronat e familjes Radovani që kanë kaluar në favor të Edi Memçaj dhe përgjimet për Gjykatën e Apelit janë rrethana të mjaftueshme që të jepet masa e sigurisë "arrest me burg". Pretendimet e Edi Memçajt, sipas gjykatës nuk i përgjigjen fazës së hetimeve. Për Ilir Sokolin po ashtu u vendos masa "arrest me burg", pasi ka bërë disa takime me shtetasin Paulin Radovani. 70 mijë euro Ilir Sokoli sipas përgjimeve ia ka marrë Edi Memçaj për t'ua dhënë djemve të ish-prefektit. Ilir Sokoli sipas përgjimeve i ka thënë që paratë nuk i ka të vetat. "Arrest me burg" i përgjigjet fazës së hetimit dhe jepet për të mos cenuar provat për Ilir Sokolin. Artan Dragani, ish-kancelari u la në "arrest burg". Në përgjime rezulton se Artan Dragani ka deklaruar se është në borxh 180 mijë euro. Paulin Radovani ka thënë se i ka borxh, por s'e di se sa ish- kancelarit. Sipas ish-prefektit, shtetasi Artan Dragani i ka sjellë lekë nga Luksemburgu dhe ia ka dhënë me fajde, ndaj gjykata në bazë të këtyre përgjimeve vendosi "Arrest me burg". Pashko Vuksanelaj u la në "arrest me burg" duke qenë se ai vetë ka pranuar se i ka dhënë shumën prej 150 mijë dollarësh me 3% në vit.




**VENDIMI I GJYKATËS SË APELIT**

| | |
|---|---|
| **1.Edi Memçaj** | 33 vjeç nga Shkodra, arrest me burg. |
| **2.Artan Dragani** | 39 vjeç nga Shkodra, arrest me burg. |
| **3.Berhan Alija** | 61 vjeç nga Shkodra, arrest me burg. |
| **4.Lul Sylja** | 48 vjeç nga Shkodra, arrest me burg me afat 60 ditë. |
| **5.Ilir Sokoli** | (ish-drejtori i Patentave) Shkodër, arrest me burg. |
| **6.Pashko Vuksanlekaj** | 54 vjec nga Shkodra, arrest me burg. |
| **7.Adri Bala** | 22 vjeç nga Shkodra, detyrim paraqitje. |
| **8.Marjan Bregu** | 31 vjeç nga Shkodra, detyrim paraqitje. |
| **9.Vinko Nikprelaj** | 37 vjeç nga Shkodra, detyrim paraqitje. |
| **10.Eduard Fusha** | 38 vjeç nga Shkodra, detyrim paraqitje. |
| **11.Elidon Qerimaj** | 41 vjeç nga Shkodra, detyrim paraqitje. |
| **12.Naim Ahmetaj** | 52 vjeç nga Puka, detyrim paraqitje. |

Shtetasi Lulzim Sylja u la në burg me afat me 60 ditë për t'i bërë ekspertizën e gjendjes së tij shëndetësore, një kërkesë kjo edhe e vetë prokurorisë. Sipas përgjimeve, shtetasi Lulzim Sylja ka pasur një pikë bastesh bashkë me djalin e Paulin Radovanit dhe djali i ish-prefektit i ka mbetur një borxh prej 100 mijë euro dhe për këtë borxh ish-prefekti i ka ofruar një pronë prej 2600 metër katror. Pretendimet për kalimin e pronës në emër të Lulzim Syljas, sipas gjykatës, tregojnë rrezikshmërinë e tij, ndërsa do të pritet ekspertiza shëndetësore, nëse ka probleme me gjendjen psikike të tij, siç pretendohet. Gjykata e Apelit ndryshoi masën e sigurisë në "detyrim paraqitje" për Adri Balën, sepse nuk ka kryer asnjë lloj veprimi dhe thjesht ka qenë shoqërues. Në "Detyrim paraqitje" u la edhe Vinko Nikprelaj, pasi vetëm i ka blerë një pronë shtetasit Paulin Radovani në shumën 140 mijë euro, ndërsa është liruar edhe Marjan Bregu me "detyrim paraqitje", pasi ky i fundit ka pranuar sipas gjykatës që i ka dhënë një borxh prej 18 mijë euro me 11% në muaj dhe ky shtetas sipas gjykatës nuk paraqet rrezikshmëri për t'u larguar dhe ka personalitet të mirë. Gjykata dha edhe për shtetasin Elidon Qerimaj "detyrim paraqitje", si dhe u lirua edhe Naim Ahmeti, pasi ky shtetas ka dashur t'i blejë një tokë Paulin Radovanit. Gjykata ka liruar edhe shtetasin Eduart Fusha. Gjykata e Apelit u shpreh në qëndrimin e saj se pretendimet e prokurorisë për këta 12 shtetas për veprën pastrim të veprës penale është e zbehtë dhe e paartikuluar mirë.

**SEANCA PËR RADOVANIN**

Menjëherë pas kësaj seance, u zhvillua në Gjykatën e Apelit në Shkodër seanca për masën e sigurisë për ish-prefektin Paulin Radovani. Në një sallë të boshatisur pa avokatin mbrojtës dhe pa praninë e ish-prefektit, Apeli la në fuqi vendimin e Shkallës së Parë me masën e sigurisë "detyrim paraqitje" dhe ndalim për të dalë jashtë vendit. Ish-prefekti akuzohet gjithashtu për veprën penale "ushtrim pa licencë të veprimtarisë bankare", ndërsa dy ditë më parë 12 të dyshuarit prej të cilëve 6 u liruan dhe 6 mbetën në "arrest me burg" e akuzojnë dhe pretendojnë se ish-prefekti i ka mashtruar dhe duhet të hetohet për mashtrim. Më parë gjykata e Shkallës së Parë në Shkodër ka vendosur "arrest me burg" për dy djemtë e ish-prefektit Robert dhe Elton Radovani, të cilët që në janar të këtij viti janë arratisur nga Shkodra dhe nuk dihet se ku janë për shkak të borxheve, që mendohen se shkojnë deri në 13 milionë euro në total. Skema e fajdeve u denoncua nga ish-prefekti i Shkodrës, Paulin Radovani. Të përfshirë sipas prokurorisë rezultojnë ish-kancelari i Gjykatës së Shkodrës Artan Dragani, një notere dhe një efektiv policie. Gjatë operacionit u sekuestruan shumë të mëdha parash, prona të luajtshme dhe të paluajtshme. Skema ishte e tillë që nëse qytetarët ose biznesmenët nuk kthenin shumat në kohë, ata humbnin prona që kishin lënë peng me marrëveshje.

## Marin Begeja: Jemi të frikësuar, të zbardhet ngjarja

# I ati vrasës serial, u ekzekutua nga policia, të birit i vënë tritol në banesë pas 17 vitesh

**SHKODËR** - Një sasi e konsiderueshme tritoli ka shpërthyer në banesën e shtetasit Marin Begeja, në fshatin Kukël të Bashkisë Vau Dejës, ndërsa ndodhej pas derës së shtëpisë. Ai mori disa dëmtime, por i shpëtoi këtij atentati. Ngjarja ka ndodhur 13 ditë më parë, por nuk është raportuar. Begeja mori disa dëmtime, por i shpëtoi këtij atentati. Marin Begeja është djali i Tom Begejës. Ky i fundit në gusht të vitit 2002 u ekzekutua nga forcat e policisë në Kukël, pasi më përpara akuzohej se kishte vrarë 5 persona, mes të cilëve një grua shtatzënë dhe djalin e tij 25-vjeçar. Marin Begeja rrëfen momentin e shpërthimit. Marin Begeja ka dyshime se vendosja e tritolit ka ardhur vetëm si shkak i konflikteve të shumta që ka lënë të hapura babai i tij, ndërsa tregon se tritoli ka qenë i telekomanduar. Nga ky shpërthim mund të kishin rrezikuar fëmijët e fshatit, që shkojnë në shkollë çdo mëngjes. Marin Begeja kërkon që policia ta zbardhë sa më parë këtë ngjarje, sepse familja e tij është e frikësuar. Babai i 43-vjeçarit, Tom Begeja në vitin 2002 ishte i shumëkërkuar për policinë, pasi akuzohej si autor i 5 vrasjeve dhe një tentative për vrasje në vitet 1993-2000. Policia kishte dështuar 3 herë për ta kapur Tom Begejën. Ngjarjet e 17 viteve më parë duket se po e përndjekin edhe sot familjen Begeja, duke i vënë tritol djalit. Marin Begeja është baba i 6 fëmijëve.



## Mbledhja me Ramën/ Valë shkarkimesh në Tatime e Dogana

Emërimi i krerëve të rinj të dy institucioneve më të rëndësishme financiare në vend duket se ka futur në reformim të gjithë administratën. Burime nga doganat bëjnë të ditur se dy drejtuesit e rinj, përkatësisht Arlind Gjokutaj në krye të Doganave si edhe Enton Duro në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, janë takuar sot me kryeministrin e vendit Edi Rama për të përcaktuar prioritetet e institucioneve. Po sipas të njëjtave burime, në këtë mbledhje kreu i qeverisë shoqërohej nga zv.kryeministri Erion Braçe si edhe ministrja e Financave, Anila Denaj. Porositë e ekzekutivit duket se kanë qenë të prera për drejtuesit rajonale të Tatimeve e Doganave. Mësohet se ndaj tyre është caktuar një afat njëmujor për të përmbushur objektivat, në të kundërt do të shkarkohen. Ristrukturimi duket se ka prekur edhe Drejtorinë e Hetimit Tatimor. Burime nga mbledhja thanë se është shkarkuar kreu i Hetimor Tatimor si edhe disa drejtuesit rajonalë, ndërsa janë dorëhequr nëndrejtorët rajonalë në Tatime e Dogana.



## BB: 35% e shqiptarëve në varfëri, jetojnë me më pak se 5 dollarë në ditë

Më shumë se një e treta e shqiptarëve jetojnë në varfëri. Banka Botërore vlerëson se shkalla e varfërisë në Shqipëri për vitin e kaluar ishte 35.2%, duke iu referuar shqiptarëve që jetojnë me më pak se pesë dollarë në ditë. Në raportin e rregullt ekonomik për Ballkanin Perëndimor të publikuar ditën e martë, raportohet se treguesi i varfërisë paraqitet në rënie gjatë viteve të fundit. Që nga viti 2015, shkalla e varfërisë në Shqipëri ka rënë me mbi tri pikë përqindje. Edhe për dy vitet në vazhdim projeksionet janë pozitive. Sipas Bankës Botërore, në vitin 2020, shkalla e varfërisë në vitin 2020 do të bjerë në rreth 33.5%. Në fakt, statistikat zyrtare të varfërisë në Shqipëri nuk janë freskuar prej vitesh. Anketa e fundit e INSTAT për matjen e nivelit të jetesës i takon vitit 2012. Publikimi më i afërt pritet me të dhëna të reja pritet të bëhet në nëntor të këtij viti. Shifrat e Bankës Botërore mbështeten në vlerësime dhe projeksione të vetë institucionit. Ulja e nivelit të varfërisë besohet të ketë ardhur nga zhvillimet pozitive në prodhim dhe në tregun e punës gjatë viteve të fundit. Shkalla e papunësisë vitin e kaluar zbriti në 12.3% dhe në harkun e pesë viteve ka rënë me mbi 5 pikë përqindje. Mbështetur në të dhënat e rritjes ekonomike, mund të përllogaritet se vitin e kaluar prodhimi i brendshëm për frymë arriti në afërsisht 560 mijë lekë në vit, ose rreth 5 mijë dollarë amerikanë. Prodhimi për frymë vlerësohet se është rritur me rreth 16% në pesë vitet e fundit. Megjithatë, rritja e pagave në ekonomi është ndjeshëm më e ulët. Sipas INSTAT, paga mesatare në ekonomi në fund të vitit të kaluar arriti në 52 mijë lekë, me një rritje prej 8% në harkun e pesë viteve.




Raporti i FMN-së, 29 rekomandime, nga emërimi i zëvendësdrejtorit të tretë te rimbursimi i TVSH-së

# FMN, kundër lehtësive fiskale, krijojnë mundësi për shmangie taksash

## *Tatimit mbi Fitimin u ul në 5 për qind për 11000 biznese*

Fondi Monetar Ndërkombëtar del kundër qeverisë për ndryshimin e sistemit fiskal në vitin 2018, ku reduktoi një sërë taksash për bizneset. Në raportin e publikuar së fundmi, FMN bën një analizë të detajuar të ndryshimeve fiskale, sipas së cilës kanë ngushtuar bazën tatimore dhe kanë ndërlikuar administrimin e taksave, duke mos rezervuar këtu kritikat për uljen e pragut të TVSH-së për bizneset e vogla. "Norma Tatimit mbi Fitimin është reduktuar nga 15 në 5 për qind për rreth 11,000 biznese. Nga ana tjetër, reduktimi i pragut të TVSH-së futi rreth 13,000 mikro biznese në sistemin e TVSH-së nga prilli i vitit 2018 dhe kjo pati ndikim minimalist te të ardhurat", shkruhet në raport. Nga ana tjetër, thuhet se paketa fiskale e 2019-ës pothuajse përgjysmoi taksën mbi dividentin nga 15 në 8 për qind dhe reduktoi TVSH-në për sektorë të veçantë. FMN konstaton se disa nga këto ndryshime komplikojnë regjimin e thjeshtë dhe të mirëstrukturuar të taksave dhe krijojnë mundësi të reja për shmangien e taksave, duke marrë si shembull manipulimin e të ardhurave të korporatave, duke i deklaruar si dividend. Krahas vlerësimeve, FMN-ja në raportin e publikuar jep edhe një serë rekomandimesh për atë që duhet bërë më tej. Në listën e rekomandimeve janë edhe rimbursimi i TVSH-së, procedurat e apelimit apo emërimi i zëvendësdrejtorit të tretë të Tatimeve.




**REKOMANDIMET**

Fondi Monetar Ndërkombëtar i rekomandon qeverisë që të planifikojë takime më të shpeshta të Komitetit të Menaxhimit të Reformës për të nxitur reforma dhe rishikimin e planit strategjik dhe të emërojë zëvendësdrejtorin e tretë në rolin vakant sa më shpejt të jetë e mundur, gjithashtu përshpejtojë plotësimin e vendeve të lira në të gjithë strukturën. "Ndryshimi i kuadrit ligjor për t'i dhënë DPT-së autoritet më të madh për të rregulluar organizimin e strukturave dhe për të shpërndarë burime. Krijimi i një procesi të fuqishëm të qeverisjes për menaxhimin e kontratës së re të IT-së në nivel më të lartë në DPT. Zhvillimi i një strategjie gjithëpërfshirëse për të ndërtuar një kulturë të fortë integriteti në të gjithë fuqinë punëtore për të adresuar rreziqet nga korrupsioni janë masat që duhet të marrë qeveria", - thotë FMN-ja. Një tjetër masë që duhet të marrë qeveria është përmirësimi i Regjistrimit dhe Shërbimeve të Tatimpaguesve. Qeveria duhet të propozojë një ndryshimi legjislativ, që lejon DPT të përditësojë regjistrin e tatimpaguesve, ku ka prova të qarta nga raportet në terren se regjistrimi i të dhënave është i pasaktë. Një tjetër detyrë është zhvillimi i një programi për të testuar saktësinë e regjistrit të tatimpaguesve, në bashkëpunim me Qendrën Kombëtare të Biznesit, duke përfshirë edhe saktësinë e regjistrit pasiv. Zhvillimi i një strategjie për shërbimin ndaj tatimpaguesve dhe vendosja e masave të qarta qeverisëse për të drejtuar zbatimin në mënyrë të koordinuar të kësaj strategjie dhe angazhimi e përfshirja e tatimpaguesve dhe ndërmjetësve të këtyre taksave më tepër si dhe hartimi i proceseve, me qëllim thjeshtësimin e pajtueshmërisë dhe uljen e kostove. Zgjerimi i gamës së udhëzimeve teknike interpretuese të publikuara janë detyrat e qeverisë për shërbimin ndaj taksapaguesve.

**DETYRAT PËR MINISTRINË**

1. Ministria e Financave dhe Ekonomisë për të përmirësuar parashikimin e të ardhurave tatimore neto dhe për të siguruar që fondet janë në dispozicion duhet të shlyejë menjëherë të gjitha pretendimet legjitime të rimbursimit të TVSH-së.
2. Ministria e Financave dhe Ekonomisë të kërkojë një ndryshim legjislativ për rimbursimin e kredive pa ndonjë pagesë minimale pa afat dhe pa detyrimin që tatimpaguesit të dorëzojnë një kërkesë të veçantë për rimbursim.

**Nga ana e Shoqerise "Sherbimi Permbarimore AB" Shpk eshte shpallur ankandi faza e dyte per pasurine e meposhtme:**

1-"Apartament" me siperfaqe totale 125 m2 me Nr.pasurie 4/63+1-42 ne Zonen Kadastrale 8602 Volumi 16 Faqe 109 e ndodhur ne Vlore. Cmimi fillestar per shitjen ne ankand te pasurise eshte 38,528 (tridhjete e tete mije e peseqind e njezet e tete) Euro.

Ankandi do te zhvillohet ne date **19.04.2019 ne oren 16:00** prane zyres se shoqerise "Sherbimi Permbarimore AB" Shpk me Permbarues Gjyqesor Privat Admir Beqiri te ndodhur ne adresen Rr.Bul Zhan Dark Pall.Kulla.1Teknoprojekt Shk.1 Kat.4 Ap.10 Tirane.

**NJOFTIM PUNESIMI**

Mundësi punësimi, **PËRKTHYES TURQISHT.**
Adresa: Pashaliman, Orikum. Shtabi i Ekipit në Shqipëri kërkon të punësojë me kontratë përkthyes Turqisht.
**Nr i kontaktit: Cel:0676525266.**

**Shoqeria permbarimore JUSTITIA**

Shoqeria permbarimore JUSTITIA shpall ankandin, faza e dyte , për shitjen e pasurisë së paluajtshme per te cilen ka vene hipoteke BKT BANK, me këto të dhëna:

Ø Pasuria "ARE" nr. 17/5, Zona Kadastrale 3339, me sipërfaqe 7780 m² faqe 190 vol.5, e ndodhur në Vrrin Duurrës, në pronësi të z.Adrian Sefer Kapllani dtl.08.03.1969, zj.Merita Myzafer Kapllani dtl.24.06.1970 Në vlerën 8.120.000 (tetë milion e njëqind e njëzetë mijë ) Lekë.
Ø Pasuria Apartament me sip.120m2 nr.pas.41/150+1-1 zk.8518 vol.116 fq.54 me adresë:Plazh /13 Durrës në pronësi të z.Adrian Sefer Kapllani dtl.08.03.1969.
Në vlerën 3.767.299 ( tre milion e shtatëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e dyqind e nëntëdhjetë e nëntë ) lekë.

Ankandi zhvillohet në datën 11.04 2019, në përfundim të orarit zyrtar, ora 16:30 në zyrën e përmbaruesit gjyqësor me adrese Bulevardi"Bajram Curri", Pall. 21,Shk. 3, Ap. 18, Tiranë.

Pronarët duhet të tërheqin dokumentin në Zyrat e Regjistrimit të Pasurive

# Hipoteka, 1100 personat që kanë gati tapitë e shtëpive

## *Përfituesit e certifikatave në qarkun e Elbasanit*

Publikohet lista me 1100 pronarët që kanë gati certifikatat e pronësisë. Përfituesit janë në qarkun e Elbasanit, ku përfshihet Librazhdi, Gramshi, Peqini, Belshi, Cërriku dhe Përrenjasi. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Elbasan, publikon listën me 1100 persona që kanë përfituar lejet e legalizimit dhe që duhet shkojnë në Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për të aplikuar për certifikatë pronësie.

**TAPIA**

Procedurat për marrjen e tapisë janë ndjekur nga ALUIZNI, i cili dorëzon dosjen e plotë në Hipotekë, por përfituesit duhet të shkojnë në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të aplikojnë për tapitë. Pas ndryshimeve të fundit ligjore, qytetari do të marrë një kopje për të vërtetuar mbarimin e procesit të legalizimit, por e gjithë procedura vijuese për regjistrimin në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme do të bëhet nga 'Agjencia'. Ndërkohë që sipërfaqja e parcelës për të cilën miratohet kalimi i së drejtës së pronësisë nuk mund të jetë më e madhe se trefishi i sipërfaqes së bazës së ndërtimit dhe për ndërtimet pa leje me funksion banimi jo më shumë se 500 m². Sipërfaqet mbi masat e përcaktuara në këtë pikë, të cilat për shkak të përmasave ose konfiguracionit nuk mund të shfrytëzohen më vete për ndërtim, i shiten poseduesit të ndërtimit pa leje sipas vlerës së pronës, të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave, vetëm nëse ka shprehur më parë vullnetin nëpërmjet një kërkese me shkrim. Ndërsa në rastin kur ndërtimi pa leje disponohet nga më shumë se një person fizik ose juridik, regjistrimi i pjesëve takuese mbi pasuritë (parcelë dhe objekt) kryhet: në pjesë të pandara, ideale, sipas numrit të subjekteve; në pjesë takuese të ndara, sipas marrëveshjes së nënshkruar ndërmjet subjekteve lirisht dhe të depozituar brenda afatit të vetëdeklarimit.

**PERSONAT QË KANË GATI TAPITË E SHTËPIVE**

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| BUJAR XHINA | NAIM KULLA | HEKURAN TOSKA | ALI LAMCJA | GENCI MULLOSMANI | NAIM BARDHI |
| BEQIR HAZIZI | SHEFIT MUSTA | VASIL GERDANI | PELLUMB GURRA | PETRIT JUPA | FATMIR SINANI |
| ALBERT LALOSHI | PULLUMB QOSJA | JAKUP HYSENI | CAPAJEV BAHUSHI | FERIDJAN KULLOLLI | QERIM PISHA |
| ZENEL KOLORIU | FADIL MALOKU | HAMDI SALLA | CAPAJEV BAHUSHI | IZET PASHTANJAKU | SULEJMAN TATA |
| AGIM SULA | ENEA META | PATRIOT XHAFERRAJ | ASTRIT SHIMA | ALBERT QOSJA | FATOS QOSJA |
| SABRI SALLA | SAIMIR ZEJNELI | FEIM SULA | LUAN TASHI | FLAMUR BAJRAMI | VASIL JOSIFI |
| MURAT AHMATI | XHEMILE BARDHI | KODHEL CALA | SHPETIM MOLLOSMANI | XHAVIT BAHO | KADRI PISHA |
| SKENDER BAJRAMI | XHEMILE BARDHI | SHEFQET XHARDJA | EDLIR MULLOSMANI | SHKELQIM CEKREZI | FETI CEKOJA |
| REFIT JOLLA | FAIK SAMURRI | AGRON BALLA | VIOLETA KYCYKU | TOMORR TOLLUMI | ARQILE MISHA |
| XHOVDET MOLI | MYFTINIA ELBASAN | GJERGJI KANACO | RAMAZAN XHARDA | PERPARIM SENJA | BERTI QOSJA |
| GENTJAN TASHI | MIMOZA DUKA | ERION HAZIZI | BLEDAR BOCI | GEZIM CEKINI | ARIF ZHUPANI |
| LUFTAR MUCA | HYSNI KOLONJARI | FOTO PRIFTI | ASTRIT GURABARDHI | SOKOL QOSJA | HYSEN BICA |
| ALI PISHA | ILIR CORA | AVDULLA HUSHI | LUFTAR MUCA | EDMOND LUMSHI | PETRIT META |
| ALFRED MUSTA | ILJAZ TOPI | YLLI BUZANI | SEFER BODURRI | BASHKIM BOJA | ARBEN ISAKU |
| SKENDER MUCA | FLAMUR OSMANI | KADRI NERGJONI | MYFTINIA ELBASAN | GJERGJI MISHA | PETRO BALLIU |
| RESMI BARDHI | YMER LUKANI | AVNI NERGJONI | MYFTINIA ELBASAN | NAZIF SAMURRI | SALI META |
| MIKEL MISHA | ISA MUSTA | KUJTIM GOGA | TOMORR QOSJA | RAMAZAN SAMURRI | MEHMET ESHJA |
| ARBEN VELI | ATMIRIM RUSTA | MINELLA DUKA | DYLAVER GURABARDHI | ADILE CARKU | ANXHELO SAMURRI |
| AGRON KUSHTI | KRENAR TAFANI | TAHIR SAMURRI | ENVERE LEPURI | NAZMI META | MUSA MALOKU |
| ZEDEF HOXHA | ALBERT CAPO | FIQIRET SAMURRI | QANI KULLOLLI | ALIM SULI | EMILJAN ZEJNELI |
| ZEDEF HOXHA | FAIK SHKURTI | BESNIK HASA | AGIM BODURRI | PIRO VERUSHI | FATOS SULA |
| ILIR XHAFERRI | FAIK LIKA | PETRIT LALOSHI | SALI ELEZI | ADRIATIK QYPI | EDMOND BOZHIQI |
| YLLI KUSHI | SKENDER RUSTA | DASHNOR OMERI | BLERIM METUSHI | GURI AGOLLI | AGRON TAFANI |
| GEZIM SENE | DASHAMIR SADUSHI | ILIR OMERI | REXHEP ASLLANI | DHURIM ISMAILI | SAIMIR TAFANI |
| ARTUR HYSENI | BESIM MUCA | ALTIN SHARA | GAZMENT STAKA | HODO RIKA | TEQJA SALI BABAJ |
| ARDIAN KOSTURI | ILMI MUSTA | AGRON SHARA | AGIM DYMYSHI | EDMIR ELEZI | SHYQYRI HASA |
| MYFTINIA ELBASAN | DASHAMIR ZYBA | AGRON SHARA | KADRI SINANI | AVNI BROSHKA | THOMA GUXHO |
| FIQIRET KARAJ | VEIS CAPO | DURIME CANI | SOKOL KOCI | ARDIAN LLESHI | ARBEN DUKA |
| HYSNI TERA | MEHMET KERA | ARBEN HOXHA | ANDROMAQI PAXHI | NEZIR QOSJA | AGIM MIFTARI |
| FESTIM QOSJA | FATMIR ZEROLLARI | YLLI SHARA | SHKELQIM SHARRA | RYZHDI PLAKA | NAZMI ZYLI |
| ARBEN BROSHKA | QANI MUCA | SERVET XHARDJA | RAJMOND SHATI | DEMIR XHELILI | SELIME HYSENI |
| FAIK HANKO | FAIK TAFANI | VISLET SHULI | MYFTINIA ELBASAN | ARDIAN RAGA | XHEVIT CEKREZI |
| VASIL HANKO | AGIM LLESHI | MUSTAFA ISLAMI | ARTUR MURATI | KADRI DYRMYSHI | PETREF ASLLANI |
| HASIM CARCIU | SYRJA PEPA | ARIAN BARDHI | ILIR PISHA | KLODIAN QYRA | MIRELA CERRIKU |
| HEKURAN BRUSHLI | SHPETIM QYRA | NEZIR PAJA | BAHRI XHAFERRI | BASHKIM GOGA | NEBI CEKREZI |
| FLORAT HANKO | ISMAIL TAFA | DENARDO ISMAILI | HAVA TURKA | LUAN PISHA | SHEFQET QYRA |
| DRITAN HANI | ARBEN XHAJA | EGLANT KOCI | LUAN CEKOJA | IBRAHIM CELA | HEKURAN SAMURRI |
| RAMAZAN CERRIKU | ARBEN CELA | ARIF KISHTA | ISUF HANOLI | SAMI BOJA | ETLIR SHABANI |
| PASHO MISHA | QANI ELEZI | YLLI BAJRAMI | ALFRED KUMRIA | VASILLO BELLO | AGIM META |
| FATJON KORRA | JANI CANTO | QAZIM RIKA | GENTJAN JUPA | EDMOND CARKU | BESNIK QUKU |
| MAHIR BUDANI | BESNIK KERA | DASHAMIR ELEZI | LULZIM PASHTANJAKU | MEHMET LECI | MEHMET PISHA |
| DILE DEDA | FATOS KERA | QANI ELEZI | ADRIATIK DEDJA | BESNIK HIDRI | AGIM QUKU |
| INDRIT BICI | SHABAN BALLA | LAVDIM MUSAJ | FLAMUR ZDRAVA | KLEO CARKU | XHEVIT GJINI |
| XHEVIT PISHA | ERVIS LESHI | MEHMET BAHJA | EDMOND ELEZI | SPIRO NERGJONI | SHYQYRI KOCI |

XHEMALI SAMURRI
FLUTUR METOSHI
FLORJAN CANGOJA
MERSIN LLESHI
RAMAZAN SUBASHI
SHPETIM CEKREZI
FADIL SAMURRI
FAIK KALARIA
ALTIN CANGOJA
PALUSH VOJA
KOSTJAN CAKALLI
VENEMIN BALLA
TAJAR LLESHI
ERNESTO HAZIZOLLI
SERVET LIKA
XHEVAIR LLESHI
NAZMI TABAKU
IKE LLESHI
NIKOLLA ZAIMI
ISLAM TAFA
DURIM ASLLANI
PETRIT IBRO
FESTIM SHKURTI
XHEMAL STAFA
SAMI BICA
QERIM MISKA
JAKUP BALLIU
RRAPUSH ZAVALINA
VJOLLCA LEKA
SERVET NUREDINI
ARBEN KACULI
ASLLAN SULI
XHEVAHIR BARDHI
HYSNI XHARDJA
KADRI KRYEMADHI
XHEVAIR LLESHI
SERVET LIKA
ERNESTO HAZIZOLLI
KLODIAN AJREDINI
VULLNET NUREDI
DORIAN KABASHI
AGIM LICI
LENCI MURATI
ARBEN LECAJ
AGRON PISHA
RESHAT CAKA
ALMA QEVANI
HEKURAN MUCA
SHYQYRI KULLOLLI
SOKOL SULA
HYSNI HIDRI
SELIM RUCI
LEDJAN LATIFI
DHIMITER SHYTI
ROLAND BUZRA
BUJAR TAFA
IBRAHIM CEKREZI
ILIRJAN CANO
BUJAR RUDA
BASHKIM BALLA
ERMIR CELA
PELLUMB KOLLARE
HEKURAN ELEZI
SHKELQIM KOTKA
FAIK KURANI
SKENDER CARCIU
TAJAR LLESHI
ZYDI BOZHIQI
VASIL TOLLUMI
SAMI XHARDJA

RAMIZ KORRA
HAXHI HOXHA
ZENEPE ALLA
SHKELQIM TAFA
ASTRIT ELEZI
RESUL MALIQI
MEHMET DAJA
FEIM CARCIU
FAIK BEQIRI
Janixhyra
XHEVDET MURATI
BAFTJAR DEBROVA
RRAPUSH KARAJ
SHAQIR PISHA
QAMIL BOCI
LUTFI PISHA
XHEVIT BARDHI
ALBERT SINA
BAKI LLAHA
BESMIR DUKA
MISIR KUKA
HYSNI HAKA
FATMIR SALLA
NUREDIN DUSHKU
TAULAND XHYRA
JASHAR PISHA
LUAN KUKA
FADIL CANGOJA
JANIS RUCI
NEZIR BAHO
MEHMET HASA
NAZMI KASA
ADILE BAXHAKU
MYZAJETE KANA
FERIT HALLA
FATI KIKIJA
LUTFI CELA
BARDHUL META
ELTON MURTINI
ILIR PAJA
BERTI ABEDINI
MEFAIL GJOLENA
DYLBER XHEMALLARI
SULEJMAN SHEHU
AVNI RAMZANAJ
FAIK META
SELAMI TABAKU
ALI KUKA
MENTOR PLAKU
DHURIM DERVISHI
ALFRED CELA
RAMADAN CARCANI
AISHE AGOLLI
HAVA TOROMANI
JAKUP ALLIU
SHEME RUSTA
IDAJET QOSJA
BAFTJAR DRAGOTI
FATMIR SKENDERI
QEMAL SENJA
XHEMIL ALIU
FATMIR DOKO
ERJON MUSAI
ALBERT SKORRA
PELLUMB BAHO
ARJOL BAHA
GENCI LLESHI
QERIM GJEVORI
MYFTINIA BROSHKE
JONUZ GJEVORI

QAMILE KARAJ
BASHKIM IBRUSHI
KADRI POKA
NAZMI SHAHINI
BARDHUL BEQIRI
DHIMITER KARAJ
LEFTER PELLUMBI
XHEVAHIR NERPJETRI
ANDREA SHKALLA
ANDREA HALIMI
JANI BODURRI
PETRAQ DEDJA
ROLAND HYSA
GENTJAN LAMCJA
SHEFQET MIRAKA
SAIMIR LIKA
FITNET KOFSHA
HEKURAN CELHEMA
KUJTIM XHYRA
HEKURAN SHTYLLA
IBRAHIM CARKU
SEJRIJE GORICA
THANAS DULJA
ARBEN CELA
PERPARIM KABASHI
SHPRESA KUKA
GENTJAN PALI
FABJAN KORRA
ASLLAN PISHA
ARBEN VLLAHI
GAZMIR PEPA
ASTRIT KOMINI
KLAJDI BAKALLI
GEZIM PISHA
MEHMET HUSHI
YZEIR KRYEMADHI
ILIR HASA
VULE MUCA
BASHKIM SOLLAKU
IZET HANKO
ISMAIL BOZHIQI
BASHKIM RUCI
BESNIK GJEVORI
FAIK DRIZA
MAREGLEN XHARDA
LUAN NERPJETRI
PANAJOT DURRO
ASTRIT SOLLAKU
MARINA VERUSHI
LIMON KALOTI
SELIM HAKA
TAHIR QYPI
AGIM SKENDERI
BLERIM SHTYLLA
KASTRIOT SHTYLLA
ALBERT PEPA
ILIRJAN XHYRA
DURIM BULLARI
KADRI BAXHAKU
BARDHUL KUSI
ARBEN DRIZARI
ARDIAN XHAFERRI
OSMAN ABAZI
TAULAND XHAKA
ARBEN XHIJA
ROLAND BIBA
MYFTINIA SERICE
MYFTINIA QAFE
ARI RUSTA
HAFIZE DUKA

LEONARD SULANJAKU
ALEKSANDER CULLHAJ
KAMER BALI
PASHO BAHA
NEXHIP XHYRA
BUJAR META
FUAT HASANI
RIZA VLLAHI
TAQI BERDUFI
FEIM MUCA
SHEFQET HAKA
BULETINA FACI
HIDAJET SINA
RAMAZAN MATRAXHIU
KUJTIM SKURA
FASLLI BROSHKA
ARBEN CAKA
BAJAME PEPA
FAIK BAJRAMI
ROLAND CELA
ISA CELA
SALI ALLUSTAJ
TANE GJINI
BUJAR TUFA
AGIM SHARRA
ILIR LECI
PRANVERA ISLAMI
KUJTIM ROCI
FERDI KOLLCAKU
BESIM LISI
FAIK ALLUSTAJ
BEHAR SULA
YLLI FAHRIU
FLORENC CALA
MAJLINDA CERENI
YLLI LAMCJA
DRITA BAHA
MEHMET BICA
BESIM CARKU
ARDIAN HAZIZI
LORENC KAZA
ARBEN PISHA
LEME NUKA
BASHKIM SINA
AZEM LECI
DRITAN ALLUSTAJ
SHEKLQIM CURA
XHEVAHIR GJIKA
VENEMIN QOSJA
BESNIK PISHA
EKISJO METUSHI
ARJAN MURATI
ARBEN SHABANI
HALIT KULLOLLI
ANI SALLA
RUSTEM KRASNIQI
BUJAR ZOTO
PELLUMB RUCI
LILE BOCI
ASTRIT CERENI
SOKOL LECAJ
MIMOZA HOXHA
SHOQATA E TE
VERBËRVE
NAIM DYRMA
HASAN BULLARI
HALIT TUFA
ANDREA XHAKOJ
ALBERT CAKA
VELI CERRIKU

AGRON QOSJA
KUJTIM BODURRI
ARBEN KASA
REXHEP SENA
HYSEN KUQJA
HETEM BENO
HALIT LEKA
QANI SHERMADHI
FLAMUR TAFA
FIDAIR CAKO
AGIM QOSJA
JANI CAKO
SEJDIN HOXHA
MALIQ HOXHA
EDMOND BILANI
AGIM MUCA
ASTRIT SHERMADHI
DALIP VERCANI
JANI KURTINA
VIKTOR BALI
SELMAN LICI
GENCI PEPA
ASTRIT PEPA
DURIM KUQJA
RESHIT KURTI
ARDJAN KUME
APOSTOL BODURRI
SANIJE ELEZI
GEZIM LALOSHI
GAZMIR SKENDERI
NAIM TAFANI
BESNIK META
SAIMIR BODURRI
ARJAN DUZHA
REXHEP GJONI
XHEVIT MURATI
ILIR KRYEMADHI
IBRAHIM HOXHA
QERIM KUKA
ABAZ LOKA
DAFINA ISUFAJ
ABAZ MALJA
BLERIM KUQJA
ALEKSANDER GJYLA
RYSTEM SULMINA
ILIR MUCA
SELMAN PLAKA
ISUF BROSHKA
KASEM METHASA
ILIR TAFANI
TAJAR BULLARI
ARBEN REXHEPI
MUSTAFA OMERI
MEXHIT BAHA
HYQMET LLESHI
BAJRAM KASA
ALEKSANDER CAKALLI
ALTIN BODURRI
LIMON BAHA
ERVIS CEHU
SOKOL TAFA
SHEFQET ROCI
ADIL KURTI
PETRIT DERVISHI
DASHAMIR HOXHA
TAULANT CAKALLI
ILIR MURATI
QEMAL MEHALLA
LINA HYSENBELLI
NDRICIM BARDHI

KUJTIM PEPA
VLADIMIR ASLLANI
RUSHAN LATIFI
SAMI GAXHJA
DEMIRE SENI
AVDI HOXHA
RAMAZAN GJONI
GEZIM DAULLJA
ASTRIT SHIMA
RRAHMAN ELEZI
ELTON SHATI
MYSLIM DEBROVA
BASHKIM AGO
KUJTIM RRESHKA
XHEMALI QUKU
MINUSH VERCANI
SERVET RAMA
REFAT CEKA
AGIM CEKOJA
FATOS SINANI
AGUSH GURABARDHI
ISLAM XHERRI
LIRI BAHA
ZUHDI URUCI
FATOS SOLLAKU
BUJAR ELEZI
SHERIF POPA
SHYQYRI ZIKA
SALI CARCIU
TAULANT LLAHA
TOMORR BALLA
MURAT AHMATI
BLERIM HASKJA
KADRI HIDRI
ERVIS HIDRI
FATMIR CARKU
FATOS HALIMLLARI
KUJTIM CEKANI
FERIT MJESHTRI
XHEVAHIR ALLA
SHERIF GJINI
FATMIR META
XHEVAHIR SAMURRI
MUSTAFA KOLA
MUHARREM HOXHA
IDAJET HYSA
VAIP HASKJA
BESIM RAMA
FLAMUR HYSA
MISIR HASKJA
IDLIR KUMRIA
GENTIAN MURATI
ANTONJO SULANJAKU
ARGJENT ISMAILI
MUSTAFA KROZI
GEZIM LICI
LULZIM SHERMADHI
PELLUMB SHERMADH
FERDINANT KUSI
SAIMIR KASA
DASHAMIR PEPA
SHPETIM KICKA
XHEMALI SHABANI
KUJTIM HASANI
MIRELA METANI
KASTRIOT ZDRAVA
FATMIR SHERMADHI
ASLLAN REKA
RRAPUSH SOLLAKU
HYSNI ROCI

HASAN TOCILA
BARDHUL LIKA
MITAT HANKO
IDRIS JOLLA
SHAHIN CERRIKU
MEHMET ZAIMI
ABDYL HASKO
KRESHNIK JOLLA
HAMIT DORA
BESIM QEFI
QEMAL ELEZI
NAZIF ZEQIRI
HYSEN RUSTA
PELLUMB CEKREZI
REFAT PISHA
RIZA MYRTA
LUAN CEKANI
SALI CEKOJA
VENEMIN PANXHI
ALBERT SHTARA
RAMAZAN KUSI
DAUT SINANI
SKENDER PARALLOI
PETRIT KOLONJARI
EUGLENT ELEZI
KRISTO KICKA
EMIN PRECI
BASHKIM CEPA
KRISTAQ ROCI
FLORAND GJONI
VALTER CAKALLI
ADRIATIK DEDJA
SHABAN PRECI
ALBERT SHARRA
ELTON KRYEMADHI
REFAT KUQJA
HAZIZ PRECI
HAMDI DURAKU
LIMAN LALA
BESIM ELEZI
VLADIMIR MURATI
SHPETIM JOLLA
FESTIM BEZATI
BLEDAR JOLLA
MURAT BEZATI
XHEVDET SHABANI
ARIFE LAMCJA
BESIM XHAKA
TOMORR LAMCJA
ADIM DYMYSHI
RAMAZAN LICI
EUGLENT ELEZI
KUJTIM MURATI
ERJON DORA
ILIRJAN FEZULLAU
SADI SAMURRI
YLBER ZEQO
FERDINAND META
LATIF URUCI
VALDET HYSA
GAZMIR SOLLAKU
KAMER SHABANI
GAZMIR SOLLAKU
ARBER KARAJ
ANDREA MALOKU
FAIK CANGOJA
XHEVIT PISHA
AGRON KUCI
ELTON RUSTA
SALI SHUSHARI

TAULANT CAPJA
ARDJAN GJOLENA
JASHAR SPAHIU
REFIK JOLLDASHI
EMVER SHABANI
AGIM SHABANI
FATMIR KISHTA
SHAQIR CELA
HASAN DYBELI
ENI XHAFA
DHIMITER DEDJA
PETRIT GJIKA
GAZMIR KASA
GAZIM SHABANI
AGRON KALLKU
FERDINANT TAFA
VLADIMIR DUNGA
SHPETIM LLESHI
PERPARIM TASHI
NANI QOSJA
NEZIR KOTKA
ARDIAN HASKJA
BUKUROSH BALI
KLODJAN JOLLA
GJYRGJI MUSAJ
METAN TAFANI
FUAT MYZYRI
ALFRED SKURA
STEFAN PAJA
ARDJAN KISHTA
AGIM MARA
BANUSH ELEZI
XHEZAR PAJA
KASTRIOT BEGOLLARI
FAIK RAMAZANI
YZEIR CERRIKU
CAJUP BRUSHLLI
MONDI PRECI
JETNOR BALI
SHYQYRI MECJA
FADIL LLESHI
ISLAM RUSTA
FLAMUR BUZDRA
BESNIK GJINI
QAMIL CELA
SAMI ESHJA
ILIR VERCANI
LLAZAR RANXHA
AVNI BAHA
RAMAZAN URUCI
LEONIDHA TRUSHI
ELDI CALA
BASHKIM
BRADASHESHI
XHAFERR XHAKOJ
HEKURAN KASA
MYFTINIA BALLDREN
ADRIAN KASA
MEHMET BURRAJ
SHERIF STAFA
ILIR GEGA
MIKEL KUME
RAMAZAN DAULLJA
DESHIRE ISA
FATMIR PISHA
GAZMIR DERVISHI
GRAMOZ GJUNI
MELADIN BEQO
KLODJAN HOXHA
AGIM META

BEHAR CEKA
PERPARIM QYRA
MEHDI BALA
AGRON BALA
HAXHI HAXHIU
SAMI VASKU
REXHEP SHABANI`
QAZIM HAZIZI
MUSA SAMURRI
HYSEN CENOLLARI
HAMZA CEKANI
SHAIP KRASNIQI
BESNIK IPEKU
FATIME LALA
NEXHMIJE ELEZI
GERALD SINANI
ORNELA CELIKU
BASHKIM CAPO
ILIRJAN HAZIZOLLI
ELMAS PISHA
ZEGJINE ZDRAVA
GENTI BEZATI
PETRIT JOLLA
BEHARE PLAKA
CLIRIM BALLIU
GEZIM XHARDJA
SAMI SENA
ARJAN DEBROVA
XHEVAHIR XIBRAKU
PETRO HASKURTI
DURIM BRAHO
AGRON KUKA
BESA SHABANI
ILIR KULLA
ISA BARDHI
KLODJAN SEJDINI
QEMAL RAMA
SANDRI DUKA
NDRICIM TAFANI
ARBEN HIDRI
REXHEP MULLAHU
QEMAL KRYEMADHI
FADIL MALOKU
SHYQYRI SAMURRI
OSMAN GUBERJA
MEHMET GASHI
QEMAL STAFA
KEVIN CARKU
ILIR GJATA
HANCE BAHO
KADRI TOSKA
ISLAM DANI
VLADIMIR KADIU
FATMIR PISHA
ZIJA DAUTI
HALIL NDREU
NIKOLL HALILI
BASHKIM PECI
QAMIL HIDA
HAXHI LLESHI
BUJAR ZOTO
KUJTIM MAZE
PANAJOT KACA
IBRAHIM SALLA
FIQERETE PISHA
ILIR META
HALIT KASA
MYFTINIA ELB
GAZMIR META
MANUSHAQE BEJLERI

FETI FAHRIU
KUJTIM IBRUSHI
DHIMITER DEDJA
FATMIR BAJRAMI
SHERIF DRAZHI
PELLUMB JOLLA
KRISTJAN KASA
BANUSH STAGA
ALMA KOPRENCA
ARBEN FEZA
ISAT ASLLANI
ZENUN URUCI
MARIGLEN CEKANI
EDUART MUCA
KUJTIM SALIU
FERIT KULLA
AGIM HUSHI
OSMAN DEMIRI
AGIM HUDHRI
ILIRJAN XHAFA
SALE MUCA
AQIF MUHA
ADRIATIK SINANI
AVNI HASA
ADRIATIK SALLA
VANGJEL HASKURTI
ZYLYF ASLLANI
RAKIP CERRIKU
ARBEN DUKA
KADRI VIDHANI
XHEMAL LICI
KLAJDI MUSAI
AGIM HYSA
MEHEDI HOXHA
LULZIM DERVISHI
HATIXHE BORUFI
FLORENC XHAKOJ
SULEJMAN ASLLANI
SAIMIR HYSA
TAHIR BODURRI
ARBEN HOXHA
SHYQYRI TAFA
LEFTER BODURRI
KOSTAQ OSMANI
DRITAN DURAKU
ASTRIT OMERI
HAXHI DEMIRI
ENGJELL QYRA
PETRIT LAMCJA
NAZMI LICI
HAZIZ MURATI
ISLAM TAFA
PULLUMB ZERO
OSMAN HIDRI
ILIR GJATA
ESMA SULEJMANI
TOMORR SINANI
XHELAL LLESHI
PELLUMB CMERI
XHEVAHIR NDREU
MUZA HAZIZI
KRISTAQ TOCI
SHEFQET HOXHA
HASAN ZORBA
LAVDIM SHULI
BESIM MIRAKA
ARJAN KOKA
ELTON HAKA
KUJTIM SKENDERI
EDUART STAKA

GENTIAN TOSKA
NAZMI HOXHA
AGIM KULLA
FAIK BICA
SHERIF HYSA
KADRI META
SELIM DUSHKU
SHPETIM GJINI
ALI KURTI
ELTON RUSTA
MEHMETALI CEZMUKA
MALO DEMIRAJ
VIKTOR BIBA
ILIR RAMA
FATMIR QYRA
JULIAN KULLOLLI
KOSTANDIN SHIMPLAKU
ARBEN MUHA
LUFTAR AHMATI
JANI TAFA
FLORI LISI
XHEVAHIR BALLIU
ISMET ZAJAKU
ANDREA JANI
ENVER KASA
ANDUEL XHYRA
HALIL RRANGA
EDMIR XHARDJA
BUJAR TAFA
DURIM QOKU
GEZIM LAZI
BASHKIM QOSJA
METAT KULLAKU
METAT KULLAKU
AZIS LIKA
OLSI BUJARI
SKENDER STAKA
LULEZIM HYSA
LULZIM CEPA
AGIM BEGA
BESIM MALJA
ARJET JANCA
INDAET NUREDINI
KUJTIM HOXHA
HASAN IDRIZI
GEZIM COLLAKU
MARJANA RUCI
FESTIM BUDANI
QANI BALLA
SHKELQIM BALLA
RAKIP VLLAHI
REXHEP GJINI
SHERIF SINANI
MAREGLEN BAHA
BLERIM GJONI
MAJLIND HIDRI
AGIM ISLAMI
DYLBER SALIASI
ARSEN JONUZI
ALEKSANDER SALLAKU
RUSHIT QEVANI
KADRI SOLLAKU
HAJDAR ZYBA
ERJON BRAHO
ARTUR KUMRIJA
BASHKIM SOTA
OLTJON DEBROVA
SHERIF GJINI
SHABAN METUSHI
VESEL SHARRA

PREMTIM ISLAMI
SAMI DURAKU
SAIMIR BARDHI
FIQIRI GJATA
FLAMUR SHTOGU
KUJTIM SHEHI
SHAQIR VOGLI
FLAMUR HOXHA
RRAHMAN PEPA
TAHIR CELA
ZYBER KASA
GEZIM TOCI
HYSNI MECJA
AGRON MUCA
NATASHA SHABANI
BESIM XHAFERRI
LATIF LLESHI
MUHARREM SHABANI
KUJTIM KUCI
VAIP HASKJA
KADRI POLISI
NAIM IDRIZI
GAZMEND KASA
KRISTAQ VERUSHI
FATMIR JOLLA
AGIM SOLLAKU
SHPETIM KOCIU
FERDINAND YZEIRI
HAKI XHOXHA
FERDINAND PISHA
ADRIAN BALLA
DRITAN ZAVALINA
HYSEN FILJA
FREDI LUSHKA
RAMAZAN KUME
SHKELQIM CAKANI
KUJTIM COGA
JAHO BASHMILI
SAIMIR XHYRA
INGRID BAHO
BASHKIM BEQARI
NADIRE KUQJA
FERIT HOXHA
ARDJAN MHILLI
BESNIK GJINI
XHEMILE BIBA
RESHIT LLESHANAKU
EDJOL RANXHA
RAMIZ HOXHA
EDMIR NIPOLLI
SHEFQET NASUFI
PETRIT BAHA
ALTIN CAKALLI
YLLI TANUSHI
FLORI SHEHI
RAMADAN GJINI
KUJTIM CAPJA
HABIB KAJA
LUAN KOLLA
DRITAN HYSA
GEZIM META
OSMAN ISAKU
TEFIK TASHI
FASLLI HOXHA
RRUZHDI HYSA
ISLAM SHUKULLI
MARIGLEN MUSTA

### Edi Rama: Xhaketa e kreut të Universitetit, e paprekur nga protesta e studentëve

# Kryeministri akuzon rektorin Mynyr Koni: Keqmenaxhimi, fajtor për problemet në UT

## "Autonomia universitare, më e madhe se ç'duhet"

Voltiza Duro

Problemet që mbart Universiteti i Tiranës lidhen me keqmenaxhimin e rektorit të këtij institucioni, Mynyr Koni. Akuza është bërë ditën e djeshme nga kryeministri Edi Rama gjatë një takimi me studentë e pedagogë të UT-së mbi ecurinë e Paktit për Universitetin. Studentët e pranishëm ngritën shqetësimet e tyre mbi mosrikonstruktimin e godinës dhe mosfunksionimin e bibliotekës dixhitale, e pas kësaj kreu i ekzekutivit theksoi se autonomia universitare është shkaktarja kryesore e problematikave të krijuara. "Protesta na dha mundësi të kemi çelësa të hapim dyert e njëri-tjetrit. Biblioteka dixhitale është e paaksesueshme dhe shkak është rektorati. Më e bukura në gjithë këtë histori ju jeni si ata që pinë kafe në anën lindore të Berlinit, që çdo gjë e kërkonin nga qeveria. Kjo është pjesa e keqmenaxhimit të UT nga rektorati dhe me keqardhje po e them nga rektori. Ngërçi vazhdon prej një kohe të gjatë. E njëjta gjë ndodh me rikonstruksionin e godinës. Problemi ynë është që autonomia universitare sot është shumë më e madhe se dje, por sensi i përgjegjshmërisë nuk është rritur. Studentët shkojnë tek ministria ndërkohë që shumë prej pikave s'e kishin adresën atje. As kjo pikë s'e ka këtu po në rektorat, edhe ato historitë me ngrohje dhe ftohje, jo suvaja, jo tualetet e kanë adresën tek rektorati. Ne nuk duam të fusim duart në sistem, të marrim mbrapsht një pjesë të kësaj autonomie",- tha Rama.

**SHKARKIM I REKTORIT?**

Pas kësaj ishin vetë studentët që kërkuan shkarkimin e Mynyr Konit nga posti i rektorit të Universitetit të Tiranës, në një kohë që kreu i qeverisë iu tha se kjo është një zgjedhje e bërë nga vetë ata. "Rektorin e keni zgjidhur ju, jo ne. Duhet të përgjigjet para jush, por ka edhe fatin që kur ju duhet të shkoni tek ai, niseni tek ministria dhe ai rri atje. Unë besoj se ligji i ri i Arsimit të Lartë i jep fuqi senatit dhe strukturave të tjera, pa llogaritur fuqinë që ka çdo student që kur bëheni bashkë rektori reagoi brenda 24 orësh. Kjo është rruga më e shëndetshme, do vendosë një standard tjetër sjelljeje të rektoriatit me gjithë pjesën tjetër. E vetmja gjë pa asnjë lëvizje në asnjë drejtim nga gjithë ajo që u krijua nga protesta e studentëve është xhaketa e rektorit të UT",- u shpreh kryeministri. Ky i fundit ka preferuar një bashkëbisedim me studentët, në vend të një fjalimi që sipas tij nuk do të ishte i mirëpritur nga të rinjtë. Rama shtoi se është i vetëdijshëm që askënd nuk e merr malli që ta dëgjojë atë me fjalim, pasi në çdo moment del në ekran. "Unë nuk po zgjatem për të mos marrë kohën e të tjerëve. Besoj që nuk është se ka njeri këtu në këtë sallë me ndonjë mall për të më parë mua duke mbajtur ndonjë fjalim. Nëse nuk më keni parë në drekë, me siguri me keni parë në mëngjes ose gjatë natës në fjalim. Dhe nëse nuk më keni parë as gjatë natës, dje me siguri më keni parë, kështu që e kam vetëdijen që s'ju ka marrë malli për një fjalim",- u shpreh kreu i ekzekutivit.



Rektori i UT, Mynyr Koni



Kryeministri Edi Rama

**AKUZA**

"Biblioteka dixhitale është e paaksesueshme dhe shkak është rektorati. Më e bukura në gjithë këtë histori ju jeni si ata që pinë kafe në anën lindore të Berlinit, që çdo gjë e kërkonin nga qeveria. Kjo është pjesa e keqmenaxhimit të UT nga rektorati dhe me keqardhje po e them nga rektori. Ngërçi vazhdon prej një kohe të gjatë. E njëjta gjë ndodh me rikonstruksionin e godinës",-tha Rama.

**AUTONOMIA UNIVERSITARE**

"Problemi ynë është që autonomia universitare sot është shumë më e madhe se dje, por sensi i përgjegjshmërisë nuk është rritur. Studentët shkojnë tek ministria ndërkohë që shumë prej pikave s'e kishin adresën atje. As kjo pikë s'e ka këtu po në rektorat, edhe ato historitë me ngrohje dhe ftohje, jo suvaja, jo tualetet e kanë adresën tek rektorati. Ne nuk duam të fusim duart në sistem, të marrim mbrapsht një pjesë të kësaj autonomie",- tha Rama.

### Shpërndahen certifikatat për 72 udhërrëfyes turistikë

Dje janë shpërndarë 72 certifikatat e para për udhërrëfyesit turistikë të licencuar. Gjatë ceremonisë së dorëzimit të tyre, ministri Klosi e vlerësoi këtë moment si shumë të rëndësishëm jo vetëm për profesionin e udhërrëfyesit, por sidomos për informacionin cilësor, që do t'i përcillet turistëve të huaj dhe vizitorëve vendas. "Nga ky moment ne kemi zyrtarisht guida të licencuara në disa fusha, që hapin rrugën për të vazhduar me këtë profesion, që për mua duhet ta tentojmë deri në fund për ta shpallur edhe profesion të litë. Kjo për të shtuar gjithmonë e më shumë cilësinë e ofrimit të shërbimit. Sot kemi vetëm 5 institucione të licencuara nga komisoni shtetëror për dhënien e këtyre trajnimeve. Do doja shumë të kemi më shumë, 2 janë në process, kemi pra 7 institucione që kërkojnë ta marrin këtë detyrë, por do doja të kemi shumë më shumë, jo vetëm në Tiranë, por edhe në Berat, Shkodër, Vlorë, sidomos ku ka universitete, por, ajo që do doja më shumë është që të rritet edhe cilësia edhe konkurrenca", tha ministri Klosi. Sipas të dhënave nga ministria e Turizmit dhe Mjedisit, rezulton se për guida profesionale të certifikuara kanë aplikuar 99 aplikantë, nga të cilët vetëm 72 kanë e kaluar me sukses, ndërsa të tjerët janë në procesin e plotësimin të dokumentacionit. "Ne duhet të kemi së bashku një diskutim se cilat janë zonat ku guidimi duhet bërë vetëm nga profesionistë, që të mos lejojmë që të kemi njerëz të palicencuar dhe jo profesionistë që e bëjnë këtë punë. Na duhet nga ju një informacion i plotë se cilat janë vendet që vizitohen më shumë, ku janë vendet që kanë nevojë për double check nga shteti apo për të qenë më të pastra, më të sigurta. Natyrisht të këtë më shumë përpjekje nga pushteti lokal për pastërtinë, për menaxhimin, për trajtimin e mbetjeve të ngurta, mbetjeve urbane",-tha ministri Klosi.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
BANKA E SHQIPERISE
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
SEKTORI I PROKURIMIT

TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: **"Shtypja e botimeve të Bankës së Shqipërisë për një periudhë një vjeçare"**

'Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 6,068,400 Lekë"**.

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411(ext. 1844), çdo ditë nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkese me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e pakthyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfituesi: Banka e Shqipërisë
BIC: STANALTR
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: "**Shtypja e botimeve të Bankës së Shqipërisë për një periudhë një vjeçare"**

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më **datë 25 Prill 2019, ora 11:00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
BANKA E SHQIPERISE
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
SEKTORI I PROKURIMIT

TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: **"Blerje një pajisje UPS për nevojat e një 'Server Room' të Bankës së Shqipërisë"**

'Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 8,700,000 Lekë"**.

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411(ext. 1844), çdo ditë nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkese me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e pakthyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfituesi: Banka e Shqipërisë
BIC: STANALTR
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: "**Blerje një pajisje UPS për nevojat e një 'Server Room' të Bankës së Shqipërisë"**

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më **datë 24 Prill 2019, ora 11:00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

# EMIGRANTËT NË GREQI
## NDRYSHIMET NË LIGJ

Ndërmjetësi ndërkulturor: Parlamenti helen miraton një tjetër dispozitë të papajtueshme

# Nënshtetësia greke, cilat janë ndryshimet që do të prekin emigrantët shqiptarë

## *Fatos Malaj: Testi i gjuhës mund të jetë penalizim për aplikantët*

Voltiza Duro

Dispozitat e projektligjit të ri për nënshtetësinë greke tashmë janë votuar në parlamentin grek. "Gazeta Shqiptare" zbardh sot të gjitha ndryshimet që u votuan e që prekin interesat e shqiptarëve që jetojnë e punojnë në shtetin helen. Me të dhënat e reja intervista para komisionit për natyralizimin do të zëvendësohet nga një test standard, bazuar në pyetje të parapërgatitura dhe të publikuara. I pyetur nga "Gazeta Shqiptare", ndërmjetësi ndërkulturor në ndihmë të emigrantëve shqiptarë në Greqi, Fatos Malaj thekson se ky test gjuhe mund të penalizojë shumë shqiptarë për marrjen e nënshtetësisë helene. "Në këtë kuadër, për konstatimin e njohurive të kërkuara të gjuhës greke- me shkrim dhe gojë, parashikohet testim i gjuhës greke paralel me nivelin B1. Besoj se kjo procedurë rreptësisht e standardizuar mbart rrezikshmërinë të përjashtojë shumë shtetas të huaj, të cilët edhe pse kanë njohuri të mjaftueshme të gjuhës së folur, u mungojnë njohuritë gramatikore për të kaluar me sukses testin me shkrim",-bën me dije Malaj. Më tej ky i fundit, thotë se qeveria greke nuk ka bërë asgjë lidhur me mësimin e greqishtes nga emigrantët. "Gjithashtu, është fakt i pamohueshëm mungesa e iniciativave të qeverisë për të organizuar mësime të gjuhës greke për të rriturit, me rezultat një numër i konsiderueshëm i kandidatëve të drejtohen në kurse private me kosto të lartë, çfarë e bën procedurën të papërballueshme",-thotë ndërmjetësi ndërkulturor.



Fatos Malaj

### DISPOZITA E POSAÇME

Një tjetër dispozitë e papajtueshme në projektligjin për nënshtetësinë helene, është edhe ajo që parashikon ndërprerjen totale të procesit, për aplikantët që ndërkohë janë transferuar jashtë Greqisë (periudha kohore mbi 18 muaj) për arsye të ndryshme (studime, punë). "Dispozita në fjalë nuk duket të jetë e pajtueshme me të drejtën komunitare, e cila parashikon zgjerim të së drejtës së qarkullimit të lirë, lëvizshmërisë dhe vendosjes në vende të tjera të BE-së, për shtetas të vendeve të tretë me status të caktuar (banorë afatgjatë, disponues të kartës blu, anëtarë të familjes greke apo të shtetasve europianë)",-shprehet Malaj për "Gazeta Shqiptare". Ndërkohë, sipas ndërmjetësit, me të dhënat e reja, shtetasit e vendeve të treta jo vetëm që nuk do kenë mundësi të zbatojnë të drejtën bazë e të pamohueshme europiane për qarkullimin dhe punësimin e lirë brenda kufijve të BE-së, por shpërngulja e detyruar për një vend pune, nga kushtet e vështira ekonomike të vendit, do të bëhet dhe arsyeja e ndërprerjes së kontaktit me shoqërinë greke. "Kështu, rrezikohen të pezullohen kërkesat e të huajve, të cilët pavarësisht se janë integruar në jetën sociale e politike, detyrohen të qëndrojnë jashtë Greqisë, duke ruajtur gjithsesi lidhjet me vendin, në mënyra të ndryshme",-thotë ndërmjetësi ndërkulturor.

### TESTI I NATYRALIZIMIT

Testi i natyralizimit do të ketë 20 pyetje të përzgjedhura ne mënyrë elektronike dhe rastësisht nga një "bankë" prej 300 pyetjesh, përgjigjet e të cilave do të jenë në dispozicion të interesuarve në faqen elektronike të ministrisë. Për aplikantët e nënshtetësisë greke do të shtohet edhe provimi i greqishtes me shkrim. Aplikuesit për nënshtetësinë do të japin dhe provim me shkrim dhe duhet të kenë nivelin A1, kurse me gojë, nivel B1. Gjithashtu do të bëhet ulje e tarifave që paguajnë aplikantët për marrjen e nënshtetësisë me paravolon e natyralizimit, pra nga 700 euro bëhet 550 euro. Por në rast se nuk kalon në komision dhe dikush do bëjë kërkesë për rishikim të dosjes, paravolo është 100 euro. Sipas hartuesve të ligjit të ri, qëllimi i dispozitave të reja është që të racionalizojë, thjeshtojë dhe të unifikojë procesin e natyralizimit (politografisi).

**550**

**EURO, TARIFA**

Gjithashtu, do të bëhet ulje e tarifave që paguajnë aplikantët për marrjen e nënshtetësisë me paravolon e natyralizimit, pra nga 700 euro bëhet 550 euro. Por në rast se nuk kalon në komision dhe dikush do bëjë kërkesë për rishikim të dosjes, paravolo është 100 euro.

### NDRYSHIMET QË U VOTUAN PËRFSHIJNË:

- Reformim të testit të natyralizimit para Komisionit përkatës, ku kandidatëve do t'u kërkohet t'i përgjigjen 20 nga 30 pyetjeve që përfshin testi.
- Pyetjet do të jenë rreth gjuhës, gjeografisë, historisë, institucioneve politike, zhvillimeve aktuale politike.
- Pyetjet do të përzgjidhen ne mënyrë elektronike dhe rastësisht nga një "bankë" prej 300 pyetjesh, përgjigjet e të cilave do të jenë në dispozicion të interesuarve në faqen elektronike të ministrisë. Ky është një sistem që zbatohet gjerësisht në shumë vende evropiane, SHBA, etj.
- Testi i reformuar pritet të eliminojë kohën që zgjat shkrimi i protokollit, e cila tani është rreth tre muaj.
- Shtohet provimi i gjuhës greke me shkrim. Aplikuesit për nënshtetësinë do të japin dhe provim me shkrim dhe duhet të kenë nivelin A1, kurse me gojë, nivel B1.
- Nuk do të japin provim aplikantët që kanë kryer 3 vite shkollë (gjimnaz ose likio) në Greqi ose kanë certifikatë të njohjes së gjuhës greke të kategorisë B1 me gojë dhe A1 me shkrim.
- Për ata që janë me moshë mbi 65 vjeç, do ketë një rregullim të veçantë që parashikon se testi do të jetë mjaft më i lehtë.
- Personat me aftësi të kufizuar mbi 67% nuk do të japin provim, por vetëm do paraqiten para komisionit.
- Ulje e tarifave që paguajnë aplikantët për marrjen e nënshtetësisë me paravolon e natyralizimit: nga 700 euro bëhet 550 euro.
- Në rast se nuk kalon në komision dhe dikush do bej kërkesë për rishikim të dosjes, paravolo është 100 euro.
- Minoritarët nuk kalojnë në provime të gjuhës.
- Ata që mbajnë lidhje të ngushta me shtetin Grek por mungojnë deri në 18 muaj rresht nga Greqia, nëse këta kishin aplikuar me përpara për marrjen e nënshtetësisë, procedura pezullohet dhe aplikimi mund të rishikohet në rast se këta kthehen sërish në Greqi.
- Ndryshon drejtoria e dhënies së nënshtetësisë. Krijohen Drejtoritë Rajonale të nënshtetësisë dhe hiqet kompetenca e nënshtetësisë nga Drejtoritë e Decentralizuara, një ndryshim që pritet të reduktojë kohën e pritjes rreth 9 muaj.
- Sipas hartuesve të ligjit të ri, qëllimi i dispozitave të reja është që të racionalizojë, thjeshtojë dhe të unifikojë procesin e natyralizimit (politografisi). Këto ndryshime pritet të lehtësojnë të gjithë emigrantët që dëshirojnë të marrin nënshtetësinë greke.


**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**BANKA E SHQIPERISE**
**DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT**
**SEKTORI I PROKURIMIT**

**TENDER I HAPUR KOMBËTAR**

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: **"Shërbimi 3-vjeçar i mirëmbajtjes dhe riparimit të motogjeneratorëve dhe stabilizatorëve të Bankës së Shqipërisë"**

'Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 8,660,000 Lekë"**.

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411(ext. 1844), çdo ditë nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkese me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e pakthyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfituesi: Banka e Shqipërisë
BIC: STANALTR
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: "**Shërbimi 3-vjeçar i mirëmbajtjes dhe riparimit të motogjeneratorëve dhe stabilizatorëve të Bankës së Shqipërisë"**

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më **datë 24 Prill 2019, ora 14:00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

Rrëfehet këngëtari: Jam shumë i mirë në 'timon', jeta mes muzikës dhe Amerikës

# Rikthimi i bujshëm i Vedat Ademit me "Oqean", Shqipëria më mungon

*"Surpriza ime për fansat, ja kur del projekti tjetër"*

Egla Xhemali

Në kërkim të dashurisë, që bëhet e përmallshme nga ikja pa kthim. Një melodi e ngrohtë, që zgjon ndjesitë kaotike të shpirtit që vuan. "Oqean" është projekti i fundit i Vedat Ademit, që e rikthen atë për të qenë më pranë fansave. Artisti vjen si rrallë herë në një intervistë ekskluzive për "Gazeta shqiptare", për të zbuluar jetën mes muzikës dhe familjes. Një zë potent, si ai i Vedatit i ka munguar publikut shqiptar. Artisti na njeh me angazhimet e tij dhe me mënyrën se si u prit lançimi i këngës. Përtej oqeanit, pranë familjes Vedati pohon se ka ndryshuar rutina e ditëve e megjithatë pranon se Shqipëria i mungon shumë. Ndër të tjera, këngëtari na tregon për porosinë që i ka dhënë të birit, se çfarë lloj timonieri është në familje,veset që i kanë ngelur nga fëmijëria e detaje të tjera, që nuk i dinim. Për të gjithë ata që e duan muzikën e Vedat Ademit, këngëtari ka rezervuar surpriza. Qëndroni në pritje!

**"Oqean" një rikthim i bujshëm në muzikë. Si është pritur kënga?**

Rikthim është në çdo projekt timin, për të qenë më pranë fansave. Kënga 'Oqean' është pritur shumë mirë dhe çdo ditë marrë mesazhe dhe urime pasi ridëgjimi i këngës (replay) është më i komentuari.

**Pas projektit të fundit, a do ketë surpriza të tjera për fansat?**

Sigurisht, momentalisht jam në Tiranë për një projekt tjetër, i cili është ndryshe nga Oqean dhe do të vijë së shpejti.

**Si ka ndryshuar jeta juaj që pas ikjes në Amerikë?**

Ka ndryshuar jeta e përditshme. Angazhimet e familjes janë më të shumta e duke qenë edhe ndryshe në stil, ka ndryshuar rutina.

**Çfarë ju mungon më shumë nga Shqipëria?**

Më mungon e gjitha!

**Kompleksi më i fortë që keni mundur të kapërceni?**

Hmmm, më i forti, nuk e di a kapërcehet, por është emocioni dhe ai çdo herë është i ndryshëm duhet kontrolluar, por dhe përjetuar.

**Porosia më e madhe që i keni dhënë birit tuaj?**

Të dojë njerëzit dhe familjen!

**Ka diçka që nuk ka ndryshuar te gruaja juaj, që nga çasti i parë që e ke njohur?**

Sinqeriteti. Kush e njeh Dorelën e din si është ajo dhe çfarë kuptoj me këtë fjalë. Ajo është e drejtpërdrejtë dhe shumë e sinqertë, i lexohet në sy.

**Çfarë lloj "timonieri" është Vedati në familje?**

Oh, jam shumë i mirë në timon! Jam drejtues i rreptë dhe i mirë! Duhen nga pak të dyja.

**Cili është ai ves që e keni nga fëmijëria?**

Pastërtia, rregulli dhe ardhja në orar. Nuk bëhet shaka me këto.

**Diçka që nuk ia lini kurrë bashkëshortes në dorë?**

Orarin.









## Sherr mes Oriolës dhe Noizy-t, çfarë ka ndodhur këtë herë?



Ata janë ndër personazhet më të komentuar të momentit. Noizy e bëri Oriola Marashin pjesë të grupit OTR, fill pas zënkës së bujshme me Encën dhe hatërmbetjeve mes tyre. Kështu 2 vite më parë lindi një shoqëri e ngushtë mes reperit dhe modeles seksi. Dyshja shiheshin shpesh në shoqërinë e njëri-tjetrit dhe u tha se Oriola do të publikonte një këngë që do të mbante markën e OTR. Mirëpo mes Noizyt dhe Oriolës duket se ka ndodhur një tjetër zënkë si ajo që ndodhi para disa muajsh kur hoqën njëri-tjetrin nga rrjetet sociale. Pasi u tha se kanë bërë sherr, ata rinisën të ndiqnin njëri-tjetrin në 'Instagram' dhe Noizy publikoi një foto ku shkroi "Kaq ishte" dhe vendosi emoji duke qeshur me lot.

Por, teksa i hodhëm një sy 'Instagramit' të tyre, vumë re se ata nuk e ndjekin përsëri njëri- tjetrin në këtë rrjet social. Çfarë të ketë ndodhur tani? Shpresojmë që të pajtohen sa më shpejt.

## E pyetën pse zgjodhi Elvanën për filmin, këngëtarja zbulon të vërtetën




Këto kohë, po bëhet nami për filmin " Dy gisht mjaltë". Që prej premierës, komedia romantike ka rrëmbyer vëmendjen e të gjithëve, dhe Ermal Mamaqi e Elvana Gjata kanë përjetuar momente mjaft të bukura nga vlerësimet që kanë marrë. Ndërkohë që ishin për premierën e filmit në Prishtinë, Ermal Mamaqi u pyet pse zgjodhi Elvanën si aktoren kryesore në filmin e tij, mirëpo këngëtarja s'i la kohë të përgjigjet: Sepse ishte ideja ime. E kam pasur ëndërr të bëj një film me Ermalin që e vogël. Në një nga darkat tona thashë hajde ta bëjmë një film dhe ky gjithë budadalliqet e mia i merr për seriozisht dhe e bëri realitet."- rrëfen Elvana duke qeshur.



## Pritjes po i vjen fundi! Ja kur do publikohet bashkëpunimi mes motrave Istrefi




Është folur gjatë për bashkëpunimin e parë të motrave Istrefi dhe shumë nga fansat e tyre po presin me pa durim klipin. Edhe më parë Era ka ndarë me fansat e saj disa pjesë të shkëputura duke zbuluar se si do të duket ajo dhe Nora në klip. Ndërsa, ditën e djeshme Era me anë të një postimi në 'Instastory' ka bërë publike datën e cila do të jetë 19 e këtij muaji. Ajo ka shkruajtur në foto '4/19' duke etiketuar dhe motrën e saj Norën. Pritet që kënga të jetë një super hit, ndërkohë që Era është duke shijuar suksesin ndërkombëtarë.




## Po përpiqej t'i gjente Stines partnere, reagimi i Gracielës ndaj Olti Currit do ju lërë pa fjalë




Ndarja e Stines me partneren e tij, Gracielën është përfolur shumë ditët e fundit dhe kjo për shkak të deklaratave dhe postimeve të ndryshme në rrjetet sociale, por edhe daljet e shpeshta publike. Në një intervistë të fundit, Stine la të kuptohet se mund të rikthehet me Gracielën nëse ajo do të sillej mirë. "Nuk them që ka mbaruar apo ka filluar. Ne kemi raporte të mira, takohemi me vajzën. Po u soll mirë, do ta shikojmë", u shpreh këngëtari. Disa orë më parë, Gracielës i ka bërë përshtypje një status në faqen e gazetarit Olti Curri në 'Facebook', ku ndjekësit pyeteshin se me cilin personazh publik Stine do të shkonte si çift. Mesa duket, ky postim i ka tërhequr vëmendjen Gracielës dhe ka reaguar me anë të një statusi në 'Instastory'. "Po dale të bëjë 6 muaj i ndarë të paktën, që dhe ai të qartësohet çfarë do të bëjë me veten dhe jetën e tij, pastaj hidh kandidaturat",- shkruan Graciela në postim.



Antonino Vadalà kishte 'blerë' policinë, doganën dhe shërbimet sekrete në Sllovaki

# Përgjohet mafiozi italian, del udhëtimi me ministrin kosovar

*I përfshirë në klanin 'Ndrangheta', ja hetimi i gazetares italiane*

Droga dhe mafia është një ndër kryefjalët e mediave italiane ditët e sotme. Lidhjet e kriminelëve me figurat politike po i shtojnë akoma edhe më shumë skandalet e përditshme. Së fundmi ka qenë televizioni publik italian RAI, i cili ka risjellë në vëmendje rastin e mafiozit kalabrez, Antonio Vadala, për të cilin ka publikuar një investigim lidhur me klanin e njohur me emrin 'Ndrangheta', i cili akuzohet edhe për trafikim droge. Në investigim raportohet, ndër të tjera se Vadala, i cili është pjesë e mafias kalabreze ka udhëtuar në aeroplanin e një ministri nga Kosova, emrin e të cilit nuk e bën të ditur. Investigimi i drejtuar nga gazetarja italiane Maria Grazia Mazzola nuk përfundon vetëm me italianin. Për lidhje me të implikohen edhe politikanë të lartë nga Sllovakia përfshirë këtu edhe ish-kryeministrin sllovak Robert Fico. Vadala, i cili në Itali akuzohej për trafikim droge ka arritur që në Sllovaki të infiltrojë njerëz të tij në pozita të larta, më saktësisht të dashurën e tij si nëpunëse në Ministrinë e Brendshme dhe këshilltare të ish-kryeministrit Fico. Gazetarja Mazzola duke folur për mediat është shprehur si kryeministri sllovak e ka mbajtur afër vetes Maria Troskova pavarësisht lidhjeve të saj me mafiozin Vadala. Sipas RAI, nga përgjimet bëhet e ditur se Vadala, që është pjesë e mafisë kalabreze, ka udhëtuar me aeroplan të Ministrit Kosovar, por pa përmendur emrin dhe pa dhënë detaje tjera. Antonio Vadala, kalabrezi me vendbanim për një kohë të gjatë në Sllovakinë lindore, i ekstraduar vitin e shkuar në Itali për trafik ndërkombëtar të një sasie të madhe të drogës, kishte shpesh shumë lekë nëpër duar për të paguar heshtjen e të kishte bashkëpunimin me zyrtarë të sferave të larta në Sllovaki: ndër ta agjentë të shërbimit sekret, policë, zyrtarë të doganës. Një lidhje e mirëfilltë korruptive që do të përfshinte, drejtuesin e atëhershëm të SIS që do t'i kushtonte një milion euro, sipas së cilës Vadala i kishte rrëfyer një agjenti të infiltruar që mafiozi e mendonte si bashkëpunëtorin e tij. Ka qenë kërkesa e gazetares Mazzola për të marrë në Sllovaki përmbajtjen e dosjes kriminale. Ajo prej shumë vitesh merret me mafiet në Belpasse të Italisë dhe pikërisht javët e shkuara është marrë me çështjen e vrasjes së Kuciak. Kanë qenë të shumta thirrjet telefonike mes Troskova, këshilluesja speciale e kryeministrit dhe të ashtuquajturit biznesmenit kalabrez, pikërisht atëherë kur vajza ishte asistente e deputetit Viliam Jasa?. Detyra e Troskova, e cila ishte e dashura e Vadala, në krah të kryeministrit e bëri të ishte prezente në takimet e çdo lloji, edhe të atyre të një niveli të lartë politik. Kryeministri e merrte me vete kudo, edhe kur krijonte situata të sikletshme si në rastin e takimit zyrtar me Gjermaninë me Angela Merkel. Mbetet e pazgjidhur çështja nëse ekziston vërtet një telefonatë mes mafiozit kalabrez, Vadala dhe kryeministrit, Robert Fico. Telefonata që daton në 2012, atëherë kur Troskova nuk kishte hyrë ende në stafin e Fico, ishte verifikuar nga Republika me rastine një artikulli për përvjetorin e vrasjes të Jan Kuciak dhe Martina Kusnirova. Kreu i socialdemokratëve, në muajin e fundit, ka bërë çmos për të përgënjeshtruar ekzistencën e asaj telefonate, duke akuzuar mediat se thonë vetëm gënjeshtra. Përveç telefonatave me Troskova, Vadala, sipas hetuesve italianë që kanë punuar mbi hetimin e drogës të sjellë nga prokura e Venecias, të cilës Mazzola i referohet, dhe që ka çuar në arrestimin e tij, i ka deklaruar agjentit të infiltruar se ishte i lidhur në mënyrë të fshehtë me persona të rangut të lartë në Sllovaki. Këto fjalë janë konfirmuar edhe në prokurorinë e Venecias, ku Vadala ka qenë ndjekur dhe përgjuar nga 2014-2018. Prokurori i Venecias, Bruno Cherchi, i ka thënë gazetares Mazzola se mafiozi kalabrez mburrej se kishte raporte direkte me ministrinë e brendshme, por edhe me doganën, policinë dhe shërbimet sekrete të Sllovakisë. "Sa herë që ndryshon politika, unë i blej", ka thënë kalabrezi nga përgjimet e bëra.



Mafiozi Kalabrez, Antonio Vadalan

**IMPLIKIMI**

Investigimi i drejtuar nga gazetarja italiane Maria Grazia Mazzola nuk përfundon vetëm me italianin. Për lidhje me të implikohen edhe politikanë të lartë nga Sllovakia përfshirë këtu edhe ish-kryeministrin sllovak Robert Fico. Vadala, i cili në Itali akuzohej për trafikim droge ka arritur që në Sllovaki të infiltrojë njerëz të tij në pozita të larta.

## Ambasadori amerikan viziton kryeministrin kosovar

# Haradinaj takon me Kossnet: SHBA qëndron e përkushtuar në partneritetin me Kosovën

Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj ka pritur në një takim ditën e djeshme, ambasadorin amerikan në Kosovë, Philip Kosnett. Përmes një postimi në "Facebook", Haradinaj ndan edhe detajet e këtij takimi. Në postim, Haradinaj shprehet se SHBA vazhdon të jetë e përkushtuar në partneritetin dhe miqësinë me Kosovën. "Takim i rregullt me ambasadorin amerikan në Kosovë Philip Kosnett. Diskutuam për sfidat dhe punën e përbashkët në avancimin e sundimit të ligjit. Kosova dhe SHBA qëndrojnë të përkushtuara në partneritetin dhe miqësinë në mes të dy popujve", shkruan Haradinaj në 'Facebook'.



**RAMUSH HARADINAJ:**

"Takim i rregullt me ambasadorin amerikan në Kosovë Philip Kosnett. Diskutuam për sfidat dhe punën e përbashkët në avancimin e sundimit të ligjit. Kosova dhe ShBA qëndrojnë të përkushtuara në partneritetin dhe miqësinë në mes të dy popujve", shkruan Haradinaj në 'Facebook'.

# Institucionet e Kosovës përgënjeshtrojnë Vuçiç

Një letër që am basada britanike në Kosovë ua ka dërguar qytetarëve të saj që të shmangin udhëtimet në veri të Kosovës, ka shtyrë që të reagojnë krerë të shtetit serb. Presidenti serb ka thënë se ka frikë nga situata në Kosovë, për të cilën sipas tij flitet çdo ditë, dhe se nuk ka zgjidhje për problemin e Kosovës, ndërsa ministri i Jashtëm, Daciç për këtë gjë ka akuzuar qeverinë e Kosovës. Por menjëherë ka reaguar ambasada britanike në Kosovë. Përmes një statusi në 'Facebook' ajo ka sqaruar se prej disa vitesh ambasada ka këshilluar të shmangen udhëtimet në komunat veriore, përveç atyre të domosdoshme për shkak të një numri incidentesh të dhunshme të kohëve të fundit të lidhura me krimin e organizuar në veri të Kosovës. Ndërsa ka mohuar raportimet e ndryshme në media se Britania e Madhe ka këshilluar qytetarët e saj që të mos udhëtojnë në Kosovë. Qeveria e Kosovës nuk ka dashur të komentojë lidhur me këtë çështje duke thënë se është të prononcuar ambasada britanike.



## SHKURT

### Greqi/Arrestohet çifti shqiptar dhe e mitura greke me 34 kg drogë

Një çift shqiptar dhe një e mitur greke u arrestuan në Athinë për posedim të 34 kilogramë drogë të llojit marijuanë. Operacioni u zhvillua në banesën e shqiptarit, 48 vjeç, banues në Athinë. Në total, u sekuestruan 34 kg 294 gramë marijuanë, 7750 euro dhe 1 motor. Gjatë operacionit u arrestua dhe një shqiptare 24-vjecare dhe 1 greke 17-vjecare.

### Rrëzohet një aeroplan, shuhet familja me 4 anëtarë në Maqedoni

Një aeroplan i vogël i tipit "Cesna PN210N" është rrëzuar dje në Maqedoni, në lokalitetin e malit "Koka e Selanikut" në malet e Jakupicës, raportojnë mediat lokale. Sipas njoftimeve të para, me këtë aeroplan po udhëtonte një familje, e cila ka humbur jetën nga fatkeqësia fatale. Bëhet fjalë për një çift bashkëshortësh me dy fëmijë. Aeroplani ka qenë me regjistrim gjerman dhe po udhëtonte nga Ohri drejt Sofjes. Mbetjet e tij janë gjetur në malet e Jakupicës, ndërsa MPB pritet të dalë me detaje. Aeroplani është të aksidentuar si pasojë e motit të keq dhe turbulencave.

### Greqi, gjendet i shkrumbuar në makinë ish-zyrtari

Një person u gjet i djegur në një makinë të shkrumbuar nga flakët në zonën e Fokidës, në rrugën që shkon nga Amfisa në Prosilio, pasditen e së martës në Greqi. Forca të shumta policore dhe zjarrfikës shkuan në vend, dhe po hetohet nëse në këtë rast është një aksident apo një veprim kriminal. Sipas informacioneve më të fundit makina është e markës Peugeot dhe dyshohet se i takon një banori 60-vjeçar nga Amfissa, një ish-zyrtar i burgut. Megjithatë, ende nuk është konstatuar nëse shoferi është i njëjti person që u gjet i djegur. Është i çuditshëm fakti se në vendin ku u gjet makina e djegur, është një rrugë ku ka kalim të shpeshtë të makinave dhe askush nuk e ka parë. Rruga është bllokuar nga policia dhe pritet mjeku ligjor për të shqyrtuar kufomën e shoferit, si dhe vijojnë hetimet për të përcaktuar rrethanat në të cilat ka ndodhur tragjedia. Në të njëjtën kohë, po punohet edhe për të identifikuar viktimën e gjetur të djegur në makinë.

## Vizita e Cipras, Zaev: Po nënshkruajmë historinë

# Kryeministri grek në Maqedoninë e Veriut pritet nga ministrat e Ekonomisë dhe Mbrojtjes



**ZORAN ZAEV:**
"Nga nënshkrimi i Marrëveshjes së Prespës, po nënshkruajmë historinë. Greqia ishte e para që nënshkroi protokollin. Kur të ktheheni pas do të shihni kohë të humbura, kur të shihni para do të shihni dy vende mike, të cilat me vendime të guximshme shkojnë para drejt së ardhmes. Marrëveshja e Prespës dhe zbatimi i saj janë garanci për të ardhmen e dy vendeve", tha Zaev.

**ALEKSIS CIPRAS:**
"Ne jemi këtu për të gjetur zgjidhje dhe për të shikuar përpara, të shohim drejt të ardhmes. T'i largojmë nyjet, të ndërtojmë ura në vend të mureve. Ne mësojmë nga historia, por edhe krijojmë historinë tonë, ky është vizion kyç për Europën dhe Ballkanin", deklaroi Cipras.

Pas luftës së ftohtë shumëvjeçare Maqedoni e Veriut-Greqi, për herë të parë, një kryeministër grek vjen për një vizitë zyrtare në Shkup. Aleksis Cipras mbërriti këtë të martë në Aeroportin Ndërkombëtar të Shkupit, të cilit iu hoq emri i mëparshëm i "Aleksandri i Madh" sipas marrëveshjes historike të Prespës. Cipras u prit nga ministrat e Mbrojtjes dhe Ekonomisë, Sheqerinska e Bekteshi, të cilët e shoqëruan në selinë e qeverisë për t'u takuar me homologun Zoran Zaev. Nuk munguan momentet e fotografive personale. Për Zoran Zaevin, dukshëm i lumtur nga vizita e Ciprasit, bëhet fjalë për një takim historik. "Nga nënshkrimi i Marrëveshjes së Prespës, po nënshkruajmë historinë. Greqia ishte e para që nënshkroi protokollin. Kur të ktheheni pas do të shihni kohë të humbura, kur të shihni para do të shihni dy vende mike, të cilat me vendime të guximshme shkojnë para drejt së ardhmes. Marrëveshja e Prespës dhe zbatimi i saj janë garanci për të ardhmen e dy vendeve", tha Zaev. Kryeministri Cipras siguroi se Greqia do të mbështesë Maqedoninë e Veriut deri në anëtarësimit e plotë në NATO dhe BE. "Ne jemi këtu për të gjetur zgjidhje dhe për të shikuar përpara, të shohim drejt të ardhmes. T'i largojmë nyjet, të ndërtojmë ura në vend të mureve. Ne mësojmë nga historia, por edhe krijojmë historinë tonë, ky është vizion kyç për Europën dhe Ballkanin", deklaroi Cipras. Gjatë vizitës në Shkup, Cipras u takua edhe me kryeparlamentarin Talat Xhaferi.

## Shpërthen dhuna pas zgjedhjeve, përleshje mes humbësve dhe fituesve

# Opozita në avantazh? Rinumërohen votat në shtatë zona të Stambollit

## *Mediat: Kush e organizoi grushtin e shtetit në kutinë e votimit?*



**MEDIAT**
Gazetat pro-qeveritare të mërkurën thanë se kishte pasur një konspiracion kundër Turqisë në zgjedhjet lokale. Gazeta Star e krahasoi rezultatin me një përpjekje grushti shteti të vitit 2016 dhe protestat kombëtare më 2013. "Kush e organizoi grushtin e shtetit në kutinë e votimit", ishte titulli i faqes së parë në 'Star'.

Pas përfundimit të votimit në Turqi, Komisioni Zgjedhor vendosi të ketë rinumërim të votave në shtatë nga 39 zonat e Stambollit. Numërimi fillestar i votave të zgjedhjeve lokale tregoi se kandidati kryesor i opozitës ishte në epërsi të ngushtë. Mirëpo Partia për Drejtësi dhe Zhvillim e presidentit, Rexhep Tayyip Erdogan, e kundërshtoi rezultatin zgjedhor në Stamboll dhe Ankara pasi humbi kontrollin në këto dy qytete kryesore të Turqisë. Mediat turke kanë thënë se kandidati i Partisë Republikane Popullore (CHP), Mansur Yavas ka shënuar fitore të qartë në Ankara, mirëpo rezultati ka qenë aq i ngushtë në Stamboll, sa që të dyja partitë kanë pretenduar fitore. Gazetat pro-qeveritare të mërkurën thanë se kishte pasur një konspiracion kundër Turqisë në zgjedhjet lokale. Gazeta Star e krahasoi rezultatin me një përpjekje grushti shteti të vitit 2016 dhe protestat kombëtare më 2013. "Kush e organizoi grushtin e shtetit në kutinë e votimit", ishte titulli i faqes së parë në 'Star'. "Ata donin të merrnin vullnetin kombëtar përmes vjedhjeve të organizuara dhe metodave të mashtrimit", shtoi ajo. Presidenti Erdogan, i cili ka dominuar politikën turke, prej kur ka ardhur në pushtet 16 vjet më parë, dhe ka udhëhequr këtë shtet me masa secilën herë më të ashpra, ka bërë fushatë intensive gjatë dy muajve të fundit për votimet e së dielës, të cilat i ka cilësuar si "çështje të mbijetesës" për Turqinë. Kujtojmë se ish-kryeministri Binali Y?ld?r?m, i konsideruar si krahu i djathtë i Erdoganit, humbi në zgjedhjet e 31 marsit përballë kandidatit opozitar Ekrem Imamoglu, duke i dhënë fund dominancës së tyre 21-vjeçare në këtë qytet. Ndërkaq, nga ana tjetër, pamjet e përleshjeve mes mbështetësve të partive kundërshtare janë bërë të zakonshme në Stamboll. Në përleshje u përfshinë mbështetës të dy partive të mëdha, asaj të Presidentit Erdogan dhe republikanëve në opozitë, kandidati i të cilëve fitoi zgjedhjet lokale në këtë qytet. Një tjetër përleshje mes mbështetësve të dy partive fiksoi në kamera edhe një grup i Euronews. Personi që ra pre e dhunës dhe që nuk arriti të thotë as emrin ishte një votues i opozitës që po jepte intervistë për një reportazh të televizionit informativ me qendër në Lion. "Kur votova kisha parasysh të ardhmen e dy fëmijëve të mi. Këtë e kam bërë gjatë dy zgjedhjeve të fundit". Tensionet janë të pazakonta për qytetin më të populluar të Turqisë, që e karakterizon fryma paqësore. Mesa duket presidenti Erdogan s'po e përtyp dot humbjen e Stambollit në zgjedhjet lokale. Me kërkesë të qeverisë, Komiteti i Lartë Elektoral në Turqi do të rinumërojë votat në zgjedhjet lokale në 39 zona të Stambollit. Kjo pasi qeveria turke dyshon në parregullsi gjatë procesit të numërimit. Fillimisht votat nisën të rinumëroheshin në shtatë zona të mëdha, ato të Sile, Bayrampasa, Atasehir, Umraniye, Beykoz, Fatih dhe Gaziosmanpasa. Kandidati i opozitës është renditur i pari në Stamboll me 25,000 vota më shumë se sa Binali Yildirim i AKP-së, i cili ka mbajtur më herët edhe postin e Kryeministrit dhe Kryetarit të Parlamentit. Shumë analistë i druhen një taktike të Erdoganit, për të përmbysur rezultatin e Stambollit. "Dikush po përhap historinë e "fillimit të fundit" të Erdoganit. Nuk zënë mend! AKP ka fituar 44,3% në këto zgjedhje dhe së bashku me nacionalistët në koalicion 51,6%. Erdogani ka një mandat deri në vitin 2023 dhe deri atëherë, nuk do të ketë zgjedhje. Mjaft bëtë këto analiza", ka shkruar Ibrahim Kalin, zëdhënësi i presidentit turk Erdogan. Në këto zgjedhje, partia AKP humbi kontrollin e Ankarasë pas 25 vitesh, ndërsa po tenton të shmangë edhe humbjen në Stamboll.

## SHKURT

### Guaidos i hiqet imuniteti, opozita vijon protestat kundër Maduros

Venezuela është katandi sur në një vend me dy parlamente që marrin vendime të kundërta nga njëri-tjetri. Në njërën nga sallat e parlamentit në Karakas, deputetët mbështetës të presidentit Maduro, i hoqën imunitetin Huan Guaidos, i njohur nga perëndimi si presidient legjitim i Venezuelës. German Escarra, deputet mbështetës i Maduros: Hapi i radhës i takon gjykatës supreme që të nisë një proces dhe të lëshojë urdhër arrest për Guaidon. Ai akuzohet për abuzim me postin publik, grabitje të parave të popullit dhe tradhti kombëtare. Më herët, Guaido mori pjesë në një seancë me deputetët mbështetës në një tjetër sallë parlamentare, ku komentoi edhe vendimin e deputetëve pro-Maduros. Juan Guaido, president i përkohshëm i Venezuelës: Ata nuk kanë të drejta ligjore për të më hequr imunitetin. Nëse u vëmë gjërave emrin e duhur, ky quhet persekutim politik dhe terrorizëm shtetëror. Deputetët e Guaidos miratuan një ligj që mbron punonjësit publikë nga persekutimi shtetëror. Ligji ishte kundër reagim ndaj dekretit të Maduros që ndalonte protestat e opozitës, që prej muajsh janë gjithnjë e më të dhunshme. Vendi po përballet me një krizë të thellë ekonomike, e shoqëruar me kolaps të sistemit energjetik, mungesë të theksuar të ujit të pijshëm dhe ushqimeve në dyqane.

### Arrestohet në SHBA vrasësi i reperit

Policia amerikane ka njoftuar se ka arrestuar vrasësin e dyshuar të reperit Nipsey Hussle. Vrasësi i dyshuar është Eric Holder. Ai u arrestua nga policia e Los Angelos, pas verifikimeve që iu janë bërë kamerave të sigurisë dhe pyetjeve që iu janë drejtuar dëshmitarëve. "Falemiderit edhe komunitetit për rritjen e ndërgjegjësimit dhe dëshmive që kanë çuar në zbardhjen e vrasjes", shkroi në rrjetet sociale shefi i policisë së Los Anxhelos, Michel Moore. Ai tha se në bazë të të dhënave policore rezulton se dy personat janë përfshirë në konflikt dhe vrasja ka ndodhur pas një mosmarrëveshje. Ai shtoi se të dy personat e konfliktuar ishin pjesë e bandave, por rasti konkret nuk kishte lidhje me "botën e krimit".

### Siri, katër sulme kamikaze në Raqqa

Katër sulme vetëvrasëse kanë ndodhur në Raqqa, ish-kryeqyteti i shtetit islamik në Siri. Lajmin e bën të ditur zëdhënësi i të ashtuquajturës Forca Demokratike siriane me shumicë kurdë, që kontrollon qytetin nga 2017, kur ja hoqën kontrollin xhihadistëve. Zëdhënësi nuk ka dhënë njoftime për viktima.

PREMIERA

# "Dashuritë e virgjëreshës Madalenë", provokimi në teatër




Fatmira Nikolli

*Regjisori Ben Apolloni: Vepra të vë në siklet, na prek ku nuk guxojmë ta prekim veten*

Monodrama "Dashuritë e virgjëreshës Madalenë" e shkrimtarit shqiptar, Ridvan Dibra, rrëfen historinë e Madalenës, në tri fazat e jetës së saj, fazat kyçe të një femre, siç thotë autori. E shkruar me një stil mjaft të mprehtë dhe e interpretuar me mjeshtri nga aktorja Arjola Demiri, shfaqja do ta vërë publikun përballë situatave të ndryshme që kalon personazhi i Madalenës së bukur, të sinqertë, e shpesh edhe naive. Madalena, përgjatë një ore, sa shfaqja zgjat, na shpalos historinë e saj, që është historia e shumë femrave shqiptare. Përmes rrëfimit të saj, herë komik, e herë shumë dramatik, ajo na bën të kuptojmë se sa e vështirë është të jesh femër, e sidomos të jesh femër në një tokë të sertë si kjo e jona.

Regjisori Ben Apolloni thotë se gjithmonë i ka pëlqyer të merret me vepra e autorë që ironinë e kanë figurë qendrore. "E, Ridvan Dibra është mjeshtër i ironisë, prandaj edhe vepra e tij, në prozë e dramë, më pëlqen shumë", shton ai. Sipas Apollonit, shfaqja "Dashuritë e virgjëreshës Madalenë", e ndërtuar mbi tekstin dramaturgjik të Dibrës, është një shfaqje teatrore "rreth ushkurit", "një shfaqje që na provokon që në titull, duke na vënë përballë dashurive të një virgjëreshe, duke na vënë përballë figurës, për mua kryesore, të krijimtarisë letrare të autorit. Janë disa skena e detaje, që një pjesë të audiencës do ta bëjnë të ndihet në siklet dhe shpresoj shumë që kjo të ndodhë, me sa më shumë prej atyre që do ta shohin shfaqjen! Arti, përveç të tjerash, më pëlqen të jetë edhe provokues, të na vërë në siklet, të na prekë ku nuk guxojmë ta prekim veten".



**VEPRA**

"Jam vetëm pesëmbëdhjetë vjeçe, sapo i kam mbushur, dhe siç e keni marrë vesh tashmë, quhem Madalenë. Nuk e di kush ma ka vënë emrin. Mami fajëson babin. Babi-mamin. Të dy fajësojnë gjyshin, që s'jeton më. Mua më pëlqen emri im, edhe pse shoqet më thonë se duket i ndryshkur, si i shekullit të kaluar"... Për një javë rresht, aq sa u dha në Teatër, unë i ndoqa të gjitha shfaqjet strukur në njërën prej lozhave të fundit. Me një ndjesi të përhershme ankthi e paniku se mos spektatorët aty poshtë dinin diçka për 'rastin tim' dhe vëmendja e tyre përqendrohej te unë. Porse frika ime dukej e kotë: spektatorët qenë të interesuar për historinë time dhe jo për praninë". I mbështetur mbi një monodramë të hershme të autorit, por me ndryshime thelbësore në strukturë e përmbajtje, romani i shkrimtarit Ridvan Dibra me titullin "Dashuritë e virgjëreshës Madalenë" u botua në nëntor.



Në qendër të veprës është fati i një femre me emrin Madalenë - përqendruar në tri periudha të rëndësishme e vendimtare të jetës së saj: në moshat 15, 25 e 40 vjeçe, ku përcaktuese bëhet sidomos etapa e parë, ajo e adoleshencës. Sepse pikërisht në këtë periudhë problemi numër një i Madalenës, shqetësimi i saj kryesor bëhet humbja e virgjërisë. Dhe këtu nis tjetërsimi e absurdi i këtij karakteri: Madalena nuk e vuan virgjërinë si fakt në vetvete (ajo është e zënë me mjaft angazhime shkollore - artistike), por sepse në grupin e saj prej pesë shoqesh vetëm ajo deklarohet e virgjër. Duke qenë e tillë, domethënë e virgjër, ajo tallet e përbuzet vazhdimisht nga shoqet e saj, tallje e përbuzje që veçse shtohen dhe ia bëjnë ferr ekzistencën. Në rrethana të tilla ajo vendos të kërkojë ndihmë. Po ku? Institucionet që mund t'i gjendeshin pranë e ta ndihmonin, si familja, shkolla, shoqëria janë në krizë të plotë e të denatyruara. Derisa Madalena vendos një ditë të zhvirgjërohet! Krejt pa dëshirën e saj. Në rastin më të parë që do t'i krijohet. Dhe ai rast paraqitet diku në banjat e pista të shkollës së saj. Kështu, ajo që duhej të ishte përvoja e parë, e bukur dhe e papërsëritshme në jetën e kësaj adoleshenteje 15-vjeçare, kthehet në një akt mekanik, banal e vulgar. Nën shenjën e këtij "vendimi" të hershëm e të detyruar (të tjerët, koha, mjedisi), përmes episodesh e situatash sa absurde e groteske, aq edhe tragjikomike, në një trajtim thuajse përherë ironik e parodik, pasqyrohen edhe dy etapat e tjera nga jeta e Madalenës, por edhe e katër shoqeve të saj. Dhe në fund të romanit lexuesi ndoshta pyet: Ishte jeta dhe fati i një femre me emrin Madalenë? A jeta dhe fati i femrës shqiptare? Apo jeta dhe fati i femrës në përgjithësi? Përtej fabulës interesante e tejet provokuese, Dibra, në gjurmët e veprave të tij më të mira na sjell një roman të strukturuar saktë e bukur, me gjuhë e fraza të përpunuara plot ndjeshmëri e hijeshi. Ndërtimi i rrëfimit në vetën e parë, përfshirja e vetë autorit (Ridvan Dibra) si personazh në vepër, komunikimet e shpeshta e të drejtpërdrejta të heroinës me lexuesit e vet etj.

PROJEKTI






# Muzeu i Kulturës Françeskane, nis me veprat e Lin Delisë

Fatmira Nikolli

## Historia e piktorit që u arratis dhe mori me vete zhgunin






Kur ka ardhur në vitin 1992, ai është kthyer me idenë të hapte një akademi arti dhe për të ribërë afresket e kishës së madhe në Shkodër dhe nuk mundi të bënte as njërën dhe as tjetrën, sepse nuk gjeti asnjë derë të hapur. Prandaj është e vështirë të kuptosh Lin Delinë pa hyrë tek ai". Kështu shprehej 5 vite më parë, Gjon Radovani kur fliste për Lin Delinë. Më 11 prill mbahet në Kuvendin Françeskan në Gjuhadol të Shkodrës një simpozium, qëllimi final i të cilit është ngritja e muzeut të kulturës Françeskane. Muzika e kompozitorëve françeksanë do shoqërojë aktivitetin, ndërsa At Flavio Cavallini do të flasë për etapat historike të pranisë françeskane në Shqipëri. Drejtoresha e Bibliotekës Kombëtare, Persida Asllani, do të ndalet te një rrëfim muzeor të kontributit kulturor të françeskanëve shqiptarë, ndërsa prof.Ardian Ndreca do të tregojë si e rikrijonte botën në art piktori Lin Delija.

Në fund të simpoziumit do të shpallet nisja e një "fundraising" (mbledhje fondesh) për ngritjen e një muzeu françeskan, projekt-ideja e të cilit prezantohet nga arkitekti Gjon Radovani. Ai do të nënshkruajë edhe kontratën e dhurimit të veprave të mjeshtrit Lin Delija nga "Art Union Albania" tek "Muzeu i Kulturës Françeskane", ndërsa veprat do të jenë të ekspozuara.

**"LIN DELIJA"**

Vite më parë Gjon Radovani çeli në Galerinë Kombëtare të Arteve ekspozitën "Lin Delija" mes sakrales dhe profanes. Ajo shtrihej në tri hapësira të veçuara, që u gjegjen tri gjendjeve të pikturës dhe vetë piktorit. Në hapësirën e parë, gjesti piktural endet në vajtje-ardhjen e një kërkimi kompleks të dyzuar në njohjen e vetvetes dhe kërkimin e rrënjëve shpirtërore. Ky binom i pandashëm do të bëhej kryefjala e ekzistencës. Hapësira e dytë ndiqte rrugëtimin e dhimbshëm të Imago Dei-t. Martirët e lirisë, të vrarët për shkak të besimit, vuajtja e prindërve dhe e bijve vijojnë me gjestin e lutjes në shenjën sakrale të përulësisë dhe besimit. Hapësira e tretë pulsonte përmes shenjtërisë së të bukurës dhe falë saj të zbulimit të njeriut. Ky kërkim i përhershëm, zanafillor dhe strukturor, thellon në të njëjtën kohë misterin e papërkufizueshëm të jetës, të qenies dhe Zotit. 112 vepra në pikturë dhe 38 vizatime qenë pjesë e ekspozitës. Ndërsa zhguni me të cilin Lin Delija u arratis në vitin 1949, u rikthye në Shqipëri 65 vite më pas. në baulen që ai pat marrë me vete në moshën 23-vjeçare kur iku, ai pat futur edhe zhgunin, veshjen e fretërve në kuvendin e të cilëve studionte pikturë para ikjes. Atë zhgun ai nuk e veshi kurrë më, por e mbajti në shtëpinë e tij në Atrodoko, derisa u nda nga jeta më 1994. Krahas tij pat ardhur edhe çadra e piktorit me firmën e tij mbi të. Ai ka lënë pas 3500 vepra që zotërohen sot nga muze të ndryshëm e koleksionistë të ndryshëm. Radovani ka thënë se nuk ka mundur të marrë shumë prej tyre, por shoqata "Art Union", zotëron rreth 120 vepra të tij, 30 vepra i disponon Galeria Kombëtare e Arteve, si dhuratë nga Erica Schütz, një koleksioniste bavareze dhe Armando Nicoletti. Ndërkohë, edhe vetë Provinca Françeskane shqiptare, ka 30 vepra, vepra të cilat Lin Delija ua dorëzoi françeskanëve të Romës, për t'ua dhuruar atyre të Shkodrës, si dhe dy vepra të koleksionistëve private.



Radovani shprehej se Tek Lini sakralja dhe profania janë një. "Profania është produkt i sakrales, prandaj nuk ka asnjë kundërshti. Ndaj edhe sakralja tek ai nuk është e mërzitshme, thjesht rrëfyese, vetëm liturgjike, aty ka një përzierje të jetës reale me jetën e përtejme. Edhe në skenat biblike të trajtuara nga Lini shihet një person real, 2000 vjet më parë, shikon një malësor, një malësore, një mëkatar, një gjykatës, njerëz të jetës së përditshme. Është një përzierje e sakralitetit me profanen".

**ARTISTI**

Lin Delija lindi në Shkodër. Ai u rrit dhe u edukua në shkollën e Fretënve Françeskanë, ku edhe mori hov së pari talenti i tij artistik. Studioi në fillim në Herceg Novi dhe pastaj në Zagreb në Akademinë e Arteve të Bukura. Më vonë, me ndihmën e Ernest Koliqit siguroi një bursë studimi në Akademinë e Arteve të Bukura në Romë. Mjeshtrit e tij të mëdhenj ishin Mario Mafai dhe Amerigo Bartoli - prej të cilëve ai mori njohuritë e teknikave bashkëkohore dhe përsosi më tej botëkuptimin e tij artistik, duke ndërthurur në mënyrë harmonike modernen me elementin etnik, shqiptar dhe ballkanik. Edhe pse studioi me mjeshtër të mëdhenj të ngjyrave, Lin Delija do të mbeste deri në fund ai që ishte, piktor origjinal me talent të rrallë, të cilin nuk pranoi ta shiste dhe ta bënte pjesë të tregut. Në vitin 1969, Lin Delija themelon Akademinë e Artit "Gjergj Fishta" dhe në vitin 1983 krijon Akademinë e Artit "Carlo Cesi" në vilën Mentuçia në Antrodoko. Piktori Lin Delija mbylli sytë më 9 prill 1994 në Romë në moshën 68- vjeçare. Sot, veprat e tij ekspozohen në Pinakotekën e Artit Modern në Vatikan, në Muzeun e Artit Bashkëkohor në Romë, në Muzeun "Lin Delija" në Antrodoko, në Muzeun Qytetës të Osimo-s, në Qendrën e Studimeve të Artit Modern në Brescia, në Galerinë e Artit Modern në Palermo, në Muzeun e Shën Anës në Quebec të Kanadasë, në Universitetin e Erlangenit në Gjermani, në Nju Jork etj. Në qytetin e Osimo-s ekziston një muze kushtuar mjeshtrit Delija, ndërsa miqtë e tij të vjetër të Antrodokos i kanë ngritur një muze në vitin 2002 në qytetin që i dha strehë bujare.

Opinioni i Ditës

# Shqiptarët në Maqedoni të Veriut mes doktrinës maqedone e shqiptare

Nga Arsim Sinani

*(vijon nga faqja 1)*



... partitë politike.

Kandidatët maqedonas, Gordana Siljanovska e VMRO d.m.th. e opozitës maqedone, Stevo Pendarovski i LSDM në pushtet dhe profesori Blerim Reka, si i vetmi shqiptar do sjellin një garë me të papritura në këto zgjedhje presidenciale pas pavarësismit të vendit nga Jugosllavia. Ky i fundit, profesori Blerim Reka sfidoi një mentalitet shtetëror që shqiptarin e do të një formati ashtu sic e ka në qeveri, pa kriter, pa dinjitet, pa platformë, thjeshtë një grup etnik që i shërben ekskluzivisht interesit të vetë dhe një grupi që i kënaq interesat vetanake, assesi të shqiptarit në Republikë. Gara presidenciale është interesante edhe për faktin se partitë maqedone menduan se do kenë një përballje monoetnike në shtetin e proklamuar multi etnik e ku etnia maqedone i mban frerët e shtetit në dorë. Kandidatura shqiptare mjaft i ka shqetësuar kampet politike maqedone për arsyen sepse nuk kishin bërë llogari se do të ketë një kandidat shqiptar, i cili ua prishi matematikat dhe kombinatorikat. Kjo për faktin se partitë maqedone me kujdes duke e përdorur abuzimin me pushtetin i mban nën dry kërkesat shqiptare nëpërmjet atyre që sot janë në pushtet d.m.th. BDI, e bishtat tjera që kanë dosje të veprimtarive kriminale dhe abuzuese në emër të një patriotizmi të rrejshëm që e proklamojnë mes shqiptarëve thjeshtë si dekor.

Kampet politike maqedone pavarësisht se me një ideologji që e plasojnë në media dëshirojnë ta dëshpërojnë votuesin shqiptar duke ia bërë me dije se s'ka gjasa për të fituar, sepse sistemi është krijuar si i tillë për ta diskriminuar shqiptarin, dëshirojnë që më tutje ta rrënojnë organizimin politik shqiptar. E vërteta është se partitë shqiptarë që marrin pjesë në koalicion me LSDM e që i përmenda më lartë nga frika e humbjes së pushtetit te shqiptarët vrapuan pa kurrfarë nevoje të futen në një garë që shqiptarin edhe më tutje e zvetënon duka ia falur fuqinë politike pakuptim skeptrit politik maqedon, e me këtë duke e trashur trupin dhe peshën politike të doktrinës maqedone. E pakuptueshme mbetet se pse e bënë këtë veprim duke iu bashkangjitur një koncepti maqedon konglomerati i partive shqiptare në pushtet, në rrethana normale të një organizimi të mirëfilltë politik e demokratik do duhej të garojnë pasi partitë janë krijuar që të marrin pjesë në garë për pushtet. Por nga ajo që pamë muajt e kaluar ku zv/kryeministri i Maqedonisë së V. Bujar Osmani është nën hetime, kur kryetari i partisë minore në qeveri, Menduh Thaçi u dënua për abuzim me zgjedhjet dhe procesin zgjedhor, kur proceset gjyqësore janë të hapura përfshirë edhe për të parin e partisë BDI në pushtet, Ali Ahmetin dhe bashkëpunëtorin e tij të ngushtë Musa Xhaferin i dëgjuam në verzione mjaft të ndjeshme, përgjigjen e gjeni lehtë se pse vrapuan të bëhen bisht i partive maqedone. Kjo s'do mend se këtyre partive do t'iu kushtojë dhe është fillimi i një procesi që e kam quajtur pranvera politike shqiptare. Që nënkupton ndryshimin e partive shqiptare që qeverisin në Maqedoninë e Veriut, pasi që nga ajo që pamë këto parti ishin në shërbim të politikës maqedone dhe punuan kundër interesave shqiptare nën tavolinë. Fundja edhe incizimet e që i dëgjuam e nuk i dëgjuam si bombat e Zaevit, treguan se në çfarë mase ishin të inkriminuar së bashku me Nikolla Gruevskin figurat kryesore shqiptarë të skenës politike në Maqedoninë e V. Prandaj u duhet që të jenë në koalicion duke e shpëtuar vetveten, pasurinë që e kanë krijuar, veprimet e turpshme që i kanë bërë dhe duke i siguruar vetvetes rahati dhe qeverisje deri sa të munden.

Realisht shqiptarët në Maqedoninë e Veriut ballafaqohen me stuhinë, e cila do t'i zhbëjë kombëtarisht e politikisht pikërisht nga njerëzit që thirreshin në emër të një kauze, të cilën nuk e kanë, por e përdorin patriotizmin e djemve dhe vajzave më të devotshme shqiptare thjesht për interesa të vetat apo në shërbim të kauzës maqedone.

Vetë lajmi që qarkullon se Akademia e Shkencave e MKDV ia ka nisur liderëve të dy partive maqedone se duhet të luftojnë t'i ruajnë këto parti shqiptarë që i kanë në qeveri flet më së miri se cilës kauzë i shërbejnë këto parti shqiptare. Vetë ky lajm flet se duhet që në mënyrë doktrinare shqiptarët të lirohen nga kjo mendësi e cila abuzon me ndjenjën shqiptare duke e shitur lirë për një post apo për një vepër kriminale e që na dëmton më tutje. Zgjedhjet presidenciale në Maqedoni të V. ka një peshë të madhe pasi që them se këto zgjedhje do të tregojnë një gjë se shqiptarët janë faktori determinues i proceseve në këtë vend, e me këtë artikulimi politik i kandidaturës së profesorit Blerim Reka dhe partive shqiptarë që e mbështesin janë shpresë për ndryshimet e pritura te shqiptarët në vend.




Opinioni i Ditës

# "Miku" i kryeministrit dhe djalit të tij

Nga Fatos Çoçoli

*(vijon nga faqja 1)*

... sipërmarrësve të vërtetë, njeri prej të cilëve i huaj, është e frikshme. Jo thjesht dhe vetëm se pehlivani mashtrues imitonte zërin e kryeministrit në telefon, apo sikur dërgonte sms nga celulari i tij. Është e frikshme pse paraqitet emblematike. Është vula e sotme, emblema e administratës sonë publike. Të gatshme për t'iu dorëzuar të parit që i ofron para nën dorë, e korruptuar deri në rrënjë të flokëve(këtu bëjnë përjashtim dy drejtuesit e bashkisë së kryeqytetit që sipërmarrësve që ankoheshin se mashtruesi u kishte grabitur paratë e ryshfeteve pa u dhënë lejen e ndërtimit, u treguan rrugën e denoncimit në prokurori). E frikshme është, gjithashtu, shuma e madhe (qindra mijëra euro) që sipërmarrësit i kishin dhënë mashtruesit, të bindur se mund të zgjidhnin hall(pra kjo shumë që duhej t'i jepej nën dorë dikujt për të të siguruar lejen e ndërtimit). Nga ana tjetër, administrata jonë publike ka po ashtu për emblemë frikën e saj nga autoriteti joligjor i drejtuesve kryesorë të shtetit. Këto emblema janë armë reale të armatës së sekserëve dhe lidhësve me drejtuesit në lejet e ndërtimit të bashkive dhe në tenderët publikë. Që qëndron e shumtë në numër, me dhëmbët prehur dhe veshët ngritur, në "mbarim të halleve" të sipërmarrësve apo edhe qytetarëve të thjeshtë që paguajnë nën dorë. Reforma në administratën tonë publike nuk ka mundur ta mposhtë apo ta mpakë këtë armatë. Ajo ka dështuar me sukses në këtë mision. Receta elektronike, aq e paraqitur me pompozitet nga qeveria në nëntor 2017, sot nuk arrin të kufizojë korrupsionin dhe abuzimin me tregun gjigand të barnave të rimbursueshme nga buxheti i shtetit. Janë 83 milionë euro në vit(mbi 10 miliardë lekë) që paguhen nga taksat tona nëpërmjet Fondit të Sigurimeve të Detyrueshme të Kujdesit Shëndetësor dhe receta elektronike nuk bën dritë as në një të njëzetën e këtyre parave tona!(pjesa më e madhe e ilaçeve të rimbursueshme tregtohen nga farmacitë, pa recetë elektronike dhe pa nënshkrim elektronik të mjekut). Nga ana tjetër, ka dështuar me sukses edhe strategjia antikorrupsion e qeverisë. Kontrolli i Lartë i Shtetit bën me dije në një auditim të tij të performancës se strategjia antikorrupsion, e nisur në vitin 2015 po me bujë nga qeveria, është në një cektinë mosveprimesh. Ajo ka shpenzuar jo në mënyrë efektive rreth 2 miliardë lekë të reja, të dhëna për periudhën e parë të zbatimit të strategjisë (2015-2017). Sipas institucionit të auditimit të jashtëm, strategjia ka mbetur jetime. Është lënë jetime nga qytetari që ka humbur besimin dhe nuk denoncon. Mungesa e një mekanizmi real mbikqyrës të strategjisë vë në rrezik zbatimin e kësaj strategjie ndërsektoriale, e cila synon të përmbushë jo vetëm programin e qeverisë, por edhe një nga 5 përparësitë për t'u anëtarësuar në Bashkimin Evropian. 51 % e fondeve për strategjinë antikorrupsion janë dhënë nga Bashkimi Europian. Jo vetëm qeveria në nivel qendror, por edhe pushteti vendor është shumë mbrapa. Sportelet "One Stop Shop" që duhej të hapeshin pikërisht për të luftuar korrupsionin janë hapur vetëm në 14 bashki dhe funksionojnë formalisht. Duhej të ishin hapur edhe në 47 bashki të tjera, por ende janë në proces. Të zhytura në cektinën e indiferencës së përgjithshme, ndoshta për të mos të kishin përfunduar me kohë. Kur në këto tre vite zbatimi të strategjisë duhej të kishin përfunduar me kohë. Shoqëria civile ka marrë fonde për këtë nismë madhore si lufta ndaj kancerit të shoqërisë sonë, por KLSH-së i rezulton se shoqatat e saj përfituese të fondeve nuk kanë bërë thuajse asgjë. Kjo është tabloja e sotme e administratës sonë publike. Bashkëqeverisja po provon të dublojë këtë administratë të sëmurë rëndë, duke u përpjekur ta detyrojë të zgjidhë qindra mijëra problemet e qytetarëve që i ankohen asaj në rrugë dixhitale. Por ata të paktë të lumtur që u zgjidhet halli apo padrejtësia janë në raport një me njëzetë, me ata që ankohen. Nga shifra e raportuar nga qeveria se deri tani mbi 28 mijë qytetarë i janë drejtuar bashkëqeverisjes, me këtë raport i bie që vetëm rreth 1 mijë e katërqind qytetarë të jenë bërë të lumtur. Qeveria duhet të publikojë jo vetëm shifrat e qytetarëve që kanë provuar të zgjidhin hallin e tyre apo të eliminojnë padrejtësinë e administratës mbi ta nëpërmjet bashkëqeverisjes, por edhe sa për qind prej tyre bashkëqeverisja ua ka zgjidhur të plotë apo pjesërisht hallin. Vetëm kështu matet sforco e qeverisë dhe nëse ajo e ka seriozisht bashkëqeverisjen me qytetarët, me gjithë përpjekjen sizifiane të kryeministrit për të komunikuar çdo ditë me dhjetëra qytetarë të thjeshtë brenda ditës, nëpërmjet platformave të rrjeteve sociale (Twitter, Whats'app, etj.). Rasti me mashtruesin që hiqej mik i fortë i kryeministrit dhe djalit të tij për të zhvatur para nuk është as i vetmi, as edhe i kufizuar. Aradha e sekserëve që orë e çast po vrasin shpresën se ky vendi ynë mund të bëhet dhe po detyrojnë njerëzit të ikin gati të dëshpëruar nga Shqipëria, është e gjitha aty. E pagoditur si duhet, madje gati e patrazuar nga qeverisja elektronike, apo nga inspektoratet e shumta dhe puna e drejtorisë së krimit ekonomik në Policinë tonë të Shtetit. Reforma e vërtetë kryhet me struktura që realisht do të kapin në rrjetë këta sekserë që si minj të pangopur e gërryejnë shtetit tonë dhe moralin e shërbimit publik nga themelet.



## HOROSKOPI

### DASHI
Mendja juaj është e gatshme për frymëzim. Kjo është një ditë e madhe për t'u stimuluar, qoftë nga njerëz të tjerë, ose nga një situatë interesante. Nëse mundeni, duhet të punoni sot në grupe. Puna në ekip po bëhet gjithmonë e më natyrshme për ju.

### DEMI
Ka një konflikt mes anës suaj më të kujdesshme, konservatore dhe anës tuaj më të egër dhe radikale sot. Të dyja do të luftojnë gjatë gjithë ditës, duke konkurruar për dominimin. Sido që të jetë, do të shijoni një ditë të larmishme plot aktivitete dhe aventura të papritura.

### BINJAKET
Të mbrosh parimet e tua sot mund të jetë e vështirë, ku realiteti është i ashpër, veçanërisht në vendin e punës. Nëse njerëzit që ju rrethojnë nuk i plotësojnë pritshmëritë tuaja, përpiquni të bëni njohje të reja. Në mënyrën tuaj, ju do të ndihmoni ta bëni botën një vend më miqësor.

### GAFORJA
Nëse do t'ju duhet të përballeni sot me një vendim, mos u mbështetni te hamendësimet. Mendojini gjërat në mënyrë të analizuar. Nëse i bëni gjërat më shumë me intelekt se me emocion, gjasat janë që të keni sukses. Instinkti është i mirë, por sot duhet të jeni realistë.

### LUANI
Nëse ekziston ndonjë aktivitet grupi i planifikuar për ju sot, prisni disa përplasje egoje, që mund të ngadalësojnë përparimin dhe që mund të çojnë në disa mosmarrëveshje të vogla. Nëse kjo ndodh, strategjia juaj më e mirë është që të mbani distancën!

### VIRGJERESHA
Dikush që dikur ju ka bërë padrejtësi po rikthehet në skenë, me synimin për të folur sërish me ju. Ju keni çdo të drejtë të refuzoni t'i jepni kohën tuaj, por kurioziteti do t'ju tërheqë drejt tyre dhe këtu nuk ka asgjë të keqe.

### PESHORJA
Dinamika e grupit është dinamika më e këndshme për ju sot, kështu që dilni nga izolimi juaj dhe kaloni sa më shumë kohë me njerëzit. Ju do të keni një kohë të mirë me shumë karaktere të ndryshme. Do të jetë në dorën tuaj për të nisur bisedat më njerëzit që ndoshta nuk i keni takuar më përpara.

### AKREPI
Problemet që keni pasur në shtëpi ose në mesin e anëtarëve të familjes suaj po nisin të zhduken dhe lajmi i mirë është se shumë shpejt do të zhduken të gjitha. Sa u përket çështjeve të dashurisë, parashikohen lajme pozitive për të lindurit në shenjën tuaj.

### SHIGJETARI
Parashikohet një ditë me fat sa u përket çështjeve të dashurisë. Shfrytëzojeni aspektin e mirë planetar për të përmbushur qëllimet tuaja. Sa i përket aspektit financiar, po mendoni që të kryeni një investim, që për momentin nuk favorizohet, ndaj do të ishte mirë që të prisni.

### BRICJAPI
Disa mundësi të reja do të dalin sot në pah, por është e rëndësishme që ju të kuptoni se jo të gjitha do të përshtaten lehtësisht në jetën tuaj. Jini të kujdesshëm ndaj këtyre skemave të reja. Ju nuk duhet të bëni kompromise për të hyrë në lojë.

### UJORI
Sot mund të mos jeni në sinkronizim me njerëzit që ju rrethojnë. Kjo mund t'ju çojë në disa mosmarrëveshje, ose keqkuptime, të cilat do t'ju duhet t'i kaloni me zgjuarsi. Kurrë mos ndryshoni metodat tuaja vetëm për të vazhduar me turmën.

### PESHQIT
Të jesh i përsosur është e pamundur, prandaj mos e synoni atë. Në punë bëni aq sa keni mundësi. Përpiquni të largoni stresin duke menduar pozitivisht. Në çështjet e dashurisë keni nevojë për një impuls të ri.



### Një vit më parë u godit me kaçavidë trajneri Gjoka

# Skandal në Shkodër, kërcënohet trajneri Canaj dhe stafi drejtues

Nuk ka paqe në Shkodër, nuk ka qetësi as kur ekipi pret vetëm zyrtarizimin për t'u rikthyer në elitën e futbollit shqiptar. Pas Ernest Gjokës, është radha e Agim Canaj të bie pre e presioneve dhe kërcënimeve. Jo vetëm trajneri i ekipit të parë, por dhe stafi drejtues, administratori Suad Lici dhe drejtori teknik Engin Firat, janë kërcënuar. Si pasojë e këtij presioni të pashembullt është pezulluar seanca stërvitore. Burimet pranë lojtarëve të Vllaznisë bëjnë me dije se presione të tilla kanë qenë prezente që në kohën e trajnerit Lika, i cili u largua drejt SHBA, por këto presione nuk janë ndalur as me ardhjen e teknikut Canaj duke vijuar në të njëjtën formë që në ditën e dytë të punës se tij. Drejtuesit e Vllaznisë, Lici, Firat dhe tekniku Canaj nuk kanë pranuar të flasin në lidhje me këtë çështje. Ende nuk ka një reagim zyrtar të klubit, por burimet bëjnë me dije se situata është tejet e rëndë dhe presionet janë të vazhdueshme ndaj stafit teknik të kuqebluve.

### Kurbinasit fitojnë 2-0, por bardhelutë kalojnë më tej. Rexhinaldo qetëson verilindorët

# Kukësi eliminon Teutën, Tirana kalon mes drithërimave

## *Luftëtari eliminon kryesuesit e Partizanit*



Jeton Selimi

Ka përfunduar me fitoren minimale 1-0 të zotëve të shtëpisë sfida e fundit çerekfinale mes Kukësit dhe Teutës, që vulos kështu dhe skuadrën e fundit gjysmëfinaliste të Kupës së Shqipërisë. Kukësi, që vinte i avantazhuar në këtë përballje pas barazimit 2-2 në "Niko Dovana" dy javë më parë, ka triumfuar në takimin e dytë dhe ka bërë të tijën biletën e fundit gjysmëfinaliste, duke larguar disi zhgënjimin e barazimit ndaj Partizanit në kampionat. Autor i golit të vetëm të takimit ishte i zakonshmi Rexhinaldo, që në minutën e 61-të, shërbehet mjaft mirë në qendër të zonës nga Korediro, dhe me gjakftohtësi e çon topin në këndin e poshtëm të Hidit. Minutat e mbetura do të shohin një Teutë, e cila ndihet e pafuqishme për të shënuar dy gola që do t'i lejonin të përmbyste rezultatin, ndërsa në kohën shtesë do të ketë karton të kuq për Kordeiron e Kukësit dhe Frashërin e Teutës me gjyqtarin Cjapi, që nuk do ta tolerojë sherrin mes tyre. Mbyllet kështu 1-0 me Kukësin që futet në grupin e katër ekipeve më të mira të Kupës së Shqipërisë.

**KUALIFIKOHEN TIRANA E LUFTËTARI**

Nuk ka më kaos dhe tension, por sigurisht drithërima dhe një lojë të fortë sportive. Pas atij spektakli të shëmtuar që dhuruan në kampionat, Tirana i kthen reston Laçit, këtë herë duke i eliminuar nga Kupa e Shqipërisë. Bardhezinjtë e Sulejlman Starovës besuan deri në fund, kaluan të parët në avantazh më Shtubinën në minutën e 29-të ndërsa me fillimin e pjesës së dytë Çokaj dyfishojë shifrat. Kurbinasit krijuan iluzionin se do të rihapin një sfidë, e cila dukej e mbyllur që në ndeshjen e parë, provuan deri në sekondën e fundit të gjenin golin që do të çonte ndeshjen në shtesë, por bardheblutë ruajtën me fanatizëm avantazhin e fituar në sfidën e parë duke siguruar në këtë mënyrë një biletë për në fazën gjysmëfinale.

Ashtu siç pritej, Partizani nuk kishte as dëshirën e as forcën e duhur për t'i shkuar deri në fund Kupës së Shqipërisë. Pas humbjes në sfidën e parë kundër Luftëtarit, të kuqtë bien dhe në Gjirokastër duke pësuar një humbje minimale 1-0. Me rezultatin e përgjithshëm 3-1, Luftëtari kualifikohet për herë të parë pas 37 vitesh në gjysmëfinalen e Kupës së Shqipërisë.




**KUPA E SHQIPËRISË**

*24 PRILL DHE 2 MAJ*

Janë datat e takimeve gjysmëfinale të Kupës së Shqipërisë, ndërsa shorti për këto gjysmëfinale do të jetë i lirë.

*EKIPET GJYSMËFINALISTE*

Skënderbeu
Tirana
Luftëtari
Kukësi

### TREMBET MILANI




## Donaruma dhe Paketa humbasin Juventusin dhe Lacion

Barazimi i djeshëm kundër Udinezes, më shumë sesa dy pikët e lëna, ka dëmtuar Milanin në organikë, pasi dy nga yjet e skuadrës, portieri Xhixho Donaruma dhe braziliani Paketa, dolën nga fusha mes dhimbjeve për shkak të dëmtimeve që pësuan. Klubi kuqezi ka bërë me dije se dy yjet e skuadrës do të mungojnë për rreth një muaj. Prognoza e dëmtimit të portierit do ta mbajë atë jashtë fushës për të paktën 3 deri në 4 javë, ndërsa brazilianin për 4 deri në 6 javë. Dy lojtarët nuk do të jEnë për sfidën kundër Juventusit dhe mbi të gjitha për takimin më të rëndësishëm të këtij sezoni, atë ndaj Lacios, ku do të ndahet dhe vendi i katërt.

### PORTIERI KUQEZI

## Strakosha drejt Anglisë, përforcohen zërat për transferimin

Thomas Strakosha po kalon një moment fantastik në Itali dhe paraqitja e tij e fundit në ndeshjen që Lacio fitoi në 'San Siro' ndaj Interit, ishte një dëshmi e qartë që është një nga portierët më të mirë në Itali dhe jo vetëm. Javë më parë, në media u raportua se ka pasur një interesim nga Totenhemi për portierin shqiptar dhe mesa duket nuk janë vetëm spekulime gazetash. Në ndeshjen ndaj Interit, në 'San Siro' ka pasur vëzhgues nga Londra për portierin e Kombëtares. Strakosha shihet si pasuesi ideal i portierit të Francës, Hugo Loris i cili me paraqitjet e tij nuk po bind më në Angli. Kështu, Totenhemi po përgatit ofertë në drejtim të Strakoshës dhe pritet që shumë shpejt të nisin bisedimet për të. Duke ditur se Strakosha ka edhe shumë vite kontratë me lacialët, Lotito nuk mund ta lejojë të largohet për një shifër më të ulët se 35 milionë euro, raportohet në mediat italiane. Sakaq, për Strakoshën ka pasur interesim të vazhdueshëm edhe nga të tjera klube, si në Itali ashtu edhe jashtë saj.




### Menaxheri i fuqishëm në krah të lojtarit

## Raiola: Jam krenar për Kin dhe Matuidin

Në ndeshjen e djeshme të Juventusit në transfertë ndaj Kaljarit në stadiumet italiane u shfaqën sërish koret raciste. Gjatë sfidës ishin të shumta fërshëllimat apo thirrjet drejt futbollistëve bardhezi, Matuidi dhe sulmuesi Moise Kin. Por pasi duroi gjatë ndeshjes, Kin i cili shënoi golin e dytë të ndeshjes, zgjodhi të festonte poshtë tribunës së tifozëve të Kaljarit duke nxitur edhe më shumë reagimin e tifozëve. Megjithatë, kjo nuk është hera e parë që në stadiumet shqiptare shfaqen të tilla akte të turpshme pasi më parë ka pasur kore raciste edhe ndaj futbollistit të Napolit, Kulibali. Ndërkohë, ditën e sotme ka reaguar edhe agjenti i Matuidi dhe Kin, Mino Raiola, i cili tha se duhet të marrë masa për shfaqjet e tilla, ndërsa shtoi se ndihej krenar për djemtë e tij. "Duhet kurojë për të vendosur masa ndaj atyre që shfaqin sjellje raciste, por edhe ndaj atyre që e justifikojnë atë në çfarëdo lloj mënyre. Duhet të jemi të bashkuar në luftën ndaj racizmit, nuk mund të jemi racista dhe italianë në të njëjtën kohë. Jam krenar me djemtë e mi dhe do të jem me ta deri në fund", tha Raiola.




www.gsh.al
GAZETA SHQIPTARE
Gazeta e gjithë shqiptarëve!
MARKETING: 0688087323
GSH
www.gsh.al
Kontakt: +355 68 40 63 842
Facebook: Gazeta Shqiptare
Intagram: gazetashqiptare.al
Twitter: Gazeta Shqiptare
E-mail: gazetashqiptare.al@gmail.com
Youtube: Gazeta Shqiptare
• Na merrni!
• Na shkruani!
• Na lexoni!
GAZETA SHQIPTARE
PENSIONET E PLEQERISË, ISSH: SI T'I LLOGARISNI
www.gsh.al
www.gsh.al
www.gsh.al
www.gsh.al
www.gsh.al
www.gsh.al